

vizionimi i



















hapësirave

publike

modern.e

EC
MA NDËRYSHE

14
MODERN.E
KËRCHJA E KAPITULLIT, HAPËSIRAT E
DËBËTURA E TËRHEQURAT E KËRCHJES



Vizionimi i hapësirave publike moderne

Autorë: Erona Bexheti, Edmond Drenogllava



Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &
Bulevardi Nënë Tereza 30B H1 Nr.5, Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Shkurt, 2022

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është realizuar nga EC Ma Ndryshe përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia, dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e EC Ma ndryshe dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së, Suedisë apo Luksemburgut.



Sweden
Sverige

LUXEMBOURG
AID & DEVELOPMENT



PËRMBAJTJA

Hyrje

- x
- 06 Rreth modernizmit
- x
- 10 Periudha e modernes në Kosovë
- x
- 16 Hapësirat publike moderne në Kosovë
 - Cilat hapësira publike?
 - Hapësirat publike në Prishtinë
 - Hapësirat publike në Gjakovë
 - Hapësirat publike në Pejë
 - Hapësirat publike në Ferizaj
 - Hapësirat publike në Gjilan
 - Hapësirat publike në Istog
- x
- 70 Hapësirat publike me potencial për intervenim
- x
- 98 Vizionimi i hapësirave publike moderne
 - Hotel "Grand", Prishtinë
 - Teatri profesionist i qytetit "Istref Begolli", Pejë
 - Ndërtesa e Postës, Ferizaj
 - Radio "Prishtina", Prishtinë
 - Kioska K67 - një dizajn modern në zhdukje

Përfundim

Bibliografia

HYRJE

Zhvillimi i arkitekturës moderne në Kosovë (1960-1990) është një ndër periudhat që solli tranzicionin më të madh në qytetet e Kosovës, ku fryma e projektimit dhe rigjenerimit urban dallonte dukshëm nga ndërtesat dhe qendrat historike ekzistuese. Kjo arkitekturë e re u ndërtua në bazë të shkatërrimit të trashëgimisë ekzistuese dhe në emër të një identiteti të ri arkitekturor. Duke ndjekur orientimin ideologjik socialist dhe modernist, qytetet e Kosovës ndoqën shembullin e qendrave tjera urbane të Jugosllavisë. Bazuar në norma e standarde univerzale, ndryshimet dhe zhvillimet e reja u aplikuan në bulevardet dhe ndërtesat e reja publike dhe të banimit në vend (Beqiri, 2018a, fq. 7-8).


E hapur ndaj cilësive të reja arkitekture të periudhës moderniste, Kosova

u bë tokë e mundësive, duke mbledhur disa nga arkitektët më të njohur të republikave tjera të Jugosllavisë. Arkitektët vendas poashtu shfrytëzuan mundësinë për të kontribuar në zhvillimin e qyteteve moderne bashkëkohore kosovare, duke e parë arkitekturën moderne si një mjet që mund të përdoret për të vendosur Krahinën e Kosovës në të njëjtin nivel të zhvillimit urban dhe teknologjik me pjesën tjetër të Jugosllavisë. Vlen të theksojmë se arkitektët vendas u përfshinë në projektimin e disa prej ndërtesave më të rëndësishme të arkitekturës moderniste në Kosovë. Shumë prej tyre, ndonëse jo të gjitha, janë përfshirë në hulumtim, me qëllimin për të nxitur reflektimin mbi vlerat arkitektonike, kulturore, sociale dhe ekonomike të ndërtesave dhe hapësirave publike moderne në vend.

Periudha e modernizmit ka sjellë në jetë disa nga veprat më të mira arkitekurore të projektuara dhe të ndërtuara ndonjëherë në Kosovë. Shumë nga këto ikona të arkitekturës i gjejmë në kryeqytet, Prishtinë, megjithatë, ky huluntim ka përfshirë edhe hapësirat publike moderne të qytetit të Pejës, Gjakovës, Ferizajt, Gjilanit dhe Istogut. Bazuar në literaturën ekzistuese, është dhënë një pasqyrë e arkitekturës moderne dhe është bërë lartësimi i rëndësisë së numrit më të madh të hapësirave dhe ndërtesave moderniste në kryeqendrat e vendit. Më pas, pas vizitave në terren, është përshkruar gjendja ekzistuese dhe janë vizionuar në vija të trasha një numër i përzgjedhur hapësirash në Prishtinë, Pejë dhe Ferizaj, që janë konsideruar si hapësira me potencial për intervenim. Në përfundim, huluntimi rezulton me vizionimin e katër hapësirave publike moderne, bazuar në tërë huluntimin e kryer nga autorët dhe gjetjet nga punëtorja njëditore e mbajtur me studentë me po të njëjtën tematikë.

Fatkeqësisht, arkitektura moderne në Kosovë karakterizohet me një reputacion negativ, duke u cilësuar si e huaj dhe e imponuar. Si rrjedhojë, ajo mbetet pak e huluntuar dhe e dokumentuar, pavarësisht vlerave kombëtare e rajonale që i posedon dhe ndikimit të rëndësishëm që ka në identitetin urban dhe arkitekturor të vendit. Për më tepër, aktualiteti i viteve të fundit, shpërftyrimi i ndërtesave dhe hapësirave publike moderiste nga gjendja e tyre burimore, na bën të mendojmë se rreziku i shkatërrimit e tjetërsimit të trashëgimisë moderne dhe memories kolektive të kësaj periudhe është gjithmonë prezent.

Ky huluntim nuk është vetëm një provokues kalimtar, përkundrazi, ai qëndron si protestues mbi neglizhencën që i është bërë ndërtesave dhe hapësirave publike të periudhës moderne në Kosovë. Kjo, sepse duhet nxitur një thirrje për të vlerësuar, mbrojtur dhe promovuar arkitekturën moderne, si dhe për të parandaluar venitjen e vazhdueshme të trashëgimisë arkitekurore moderne të vendit.



RRETH MODERNIZMIT

Ndryshimet shoqërore nuk janë fenomene të izoluar, përkundrazi, ato paraqesin zhvillimin e vazhdueshëm të shoqërisë nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm, në periudha të ndryshme kohore. Kështu, origjina e modernizmit mund të gjurmohet që nga transformimet shoqërore dhe teknologjike që shënuan fundin e shekullit të XIX-të dhe fillimin e shekullit të XX-të. Deri në përfundimin e Luftës së Parë Botërore, gjurmët e përparimeve të shekullit XIX kishin akoma ndikim të rëndësishëm në shoqërinë evropiane (Jashari-Kajtazi, 2016, fq.45).

Qysh në shekullin e XX-të, fryma e re e cila dallohet në veprat e arkitektëve si Le Corbusier, Walter Gropius, Ludwig Mies van der Rohe, paraprirë nga qëndrimet e arkitektit vjenez Adolf Loos, i cili kundërshtoi parimet e recesionit vjenez, deri në revolucionin teknik të shekullit të XIX-të, karakterizuar nga futja e strukturave metalike si elemente ndërtimi, u përqendrua më shumë në forma të pastra gjeometrike, si gjuhë kompozicionale dhe kërkesë estetike arkitekturore e kohës (Sadiki, 2020, fq.23).

Pas kësaj, një larmi stilesh si Minimalizmi, Brutalizmi, Konstruktivizmi,

etj., mund të shihen në të gjithë Evropën, të integruar në një stil të gjerë ndërkombëtar, të gjitha nën emrin e Modernizmit. Ideat moderniste kishin ndikim të gjerë, duke përshkuar artin, arkitekturën, letërsinë, besimet fetare, filozofinë, organizimin shoqëror, aktivitetet e jetës së përditshme, e madje edhe shkencën.

Lëvizja moderniste në arkitekturë u përpoq të krijonte një arkitekturë që shlyente historinë, dhe mbi bazën funksionaliste e me ndihmën e materialeve moderne, u mundua të krijonte një ndjenjë të re për hapësirën. Në përgjigje të pluralizmit stilistik në shekullin e XIX-të, modernizmi u ndikua gjithashtu nga besimi se "njerëzit modernë" që kishin lindur në shekullin e XX-të kanë nevojë për një lloj të ri të arkitekturës. Në thelb bazohet në një vizion utopik të jetës njerëzore dhe shoqërore dhe si referencë bazë kohore merr Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, duke shpjeguar tmerret që shoqëria pasoi përgjatë tyre.

Me shpirtin e tyre të tronditur nga lufta, arkitektët synonin drejt formave të reja në arkitekturë dhe në

projektet e tyre në letër parashikonin imazhin e një shoqërie të re të ngritur nga rrënojat dhe një aspekt të ri të arkitekturës që korrespondon me civilizimin teknik të periudhës në fjalë. Me shkatërrimin e morfologjisë së stiveve, ata po i ktheheshin sinjeritetit të mendimit dhe ndjenjës (Gropius, 1965, fq.19).

Në një kuptim organik, format e jashtme të arkitekturës së re ndryshonin rrënjësisht nga ato të së vjetrës, dhe jo vetëm për shkak të dëshirës së arkitektëve për inovacion, por edhe si pasojë e pashmangshme e kushteve intelektuale, sociale dhe teknike të kohës. Ky proces formalizues karakterizohet me lirimin e arkitekturës nga ornamentet, vënien e theksit në funksionin e saj, zgjidhjet koncize dhe ekonomike si dhe një ngritje intelektuale e cila ka bërë të mundur një vizion të ri hapësinor (Gropius, 1965, fq.20).


Ajo se çfarë tentuan të arrijnë shkollat moderne të asaj kohe, në krye me Bauhaus, ishte një lloj estetike industriale që pastaj do të vazhdojë edhe në konsiderimin e arkitekturës si një gjuhë që përsëritet në të gjitha vendet e botës. Pikërisht ajo së cilës

më vonë Hitchcock edhe Johnson do t'i referohen me termin "Stil Internacion-al" (Davis, 2019).

Këtë stil do ta dallojmë me përhapjen masive dhe të shpejtë në shumicën e vendeve të Evropës. Në këto kohë kur kaosi ekonomik i pasluftërave ishte problem akut dhe lufta mes klasave ishte një fakt i pashmangshëm, nevojat për strehim ishin primare. Përtej Bauhaus-it, parim i të gjithë modernizmit ka qenë që t'u ofrojë një shtëpi minimale dhe të denjë të gjithë banorëve të tokës. Parimisht modernizmi erdhi me këtë premtim, të teorizuar më vonë nga Gropius si "ekzistencë minimum" (Davis, 2019).


Racionalizmi i formave, si një trend global në atë kohë, ishte rebelues dhe kundërshtonte traditat e përgjithshme lokale. Imazhi i një rendi apo rregulli në shoqëri ideale të parregulluara, ishte gjithashtu shumë artificial dhe abstrakt, ku në emër të normave dhe standardeve universale, shumë objekte dhe qytete u bënë të paprekshme, pa ndonjë ndjenjë dhe emocion. Kjo është logjika e paradigmes moderne, sipas së cilës, gjithçka që i përket së kaluarës dhe e kujton atë duhet të shndërrohet në pluhur revolucionar (Hoxha, 2013, fq.31-32).

" ... ekzistencë minimum "



12 Shtator 2012
Josef Albers

Konstelacion struktural



PERIUDHA E MODERNES NË KOSOVË

Arkitektura dhe urbanizmi i kësaj periudhe paraqesin rezultate të drejtpërdrejta të transformimeve dhe zhvillimin mbi të cilin qytetet tona kanë fituar një "identitet socialist/modernist". Veprimet moderniste në periudhën socialiste në Kosovë ndodhën në kuadrin e një urbanizimi më të gjerë në rajon, shpesh me ambicie kontradiktore të shprehura kryesisht nëpërmjet planeve dhe projekteve që demonstronë idenë utopike të ndërtimit të një kuadri hapësinor për një shoqëri të re, të prekur nga kërkesa krejtësisht pragmatike.

Arkitektura dhe urbanizmi nga fundi i shekullit të XIX-të, gjatë Reformave të Tanzimatit, përfaqëson një nga shtresat më të prekshme të trashëgimisë së ndërtuar në Kosovë për sa i përket numrit të mbijetuar të ndërtesave dhe gjurmëve rrënjësore, për shkak të fazave të mëpasme të zhvillimit urban si dhe mungesës së një interpretimi të qëndrueshëm historik (Jerliu & Navakazi, 2019, fq.12-13).

Si rezultat, qytetet e Kosovës u përballën me sfida në ruajtjen e vazhdimësisë së tyre historike dhe kulturore, por më e rëndësishmja, atyre u

mungon interpretimi në trendet modernizuese të fundit të shekullit XIX dhe shekullit XX. Megjithatë, disa ndërtesa, veçanërisht lloji i ndërtesave me karakter publik që kanë mbijetuar deri sot, japin dëshmi të këtyre trendeve që dikur ishin prodhuar edhe në qytetet tona (Jerliu & Navakazi, 2019, fq.12-13).

Kosova, për dallim nga qendrat e tjera të ish-Jugosllavisë, nuk e kishte përjetuar fazën e modernes në mes të dy luftërave botërore. Si rezultat i kësaj, gjuha estetike me të cilën shprehej arkitektura e pas LDB-së ishte krejtësisht e panjohur për qytetarët e saj. Nën ritmet e shpejta të urbanizimit vërehen forma dhe investime të reja në çdo sferë të jetës. Megjithatë, duhet theksuar që ky investim u krijua në emër të shkatërrimit të historisë dhe me qëllimin e krijimit të një realiteti dhe identiteti të ri arkitektonik, duke vënë në pikëpyetje marrëdhëniet me urbanitetin dhe kontekstin lokal e kombëtar. Një numër i madh i ndërtesave historike dhe bërthamave të vjetra të qyteteve u shkatërruan për t'i hapur rrugë ndërtimeve të reja moderniste (Beqiri, 2020, fq.5-6).

modern
high
concrete



historic
low
tiles

Hersher, 2010

Pas vitit 1950, kur filloi zhvillimi shoqëror, kulturor dhe arkitektonik i Prishtinës, qyteti ngadalë kishte filluar të transformohet në një "qytet modern bashkëkohor". Megjithatë, zhvillimet më të mëdha filluan gjatë viteve të '70 dhe vazhduan në mënyrë dinamike pothuajse deri në fund të viteve të '80, për t'i dhënë me të drejtë kësaj periudhe epitelin e kohëve të arta. Gjatë kësaj faze, Kosova u godit nga një mori ngjarjesh të papritura dhe të pakëndshme, të cilat kishin një ndikim të rëndësishëm në çështjet arkitektonike dhe hapësinore. Në këtë kontekst po themi "të pakëndshme" sepse këto dukuri shkatërruan atë që mund të quhet "origjinale", duke pozicionuar Kosovën si hapësirë urbane e cila mirëpret modernizmin si një prirje për të mposhtur traditën (Jashari-Kajtazi, 2016, fq.10-13). Këto ndryshime ishin të qëllimshme me pretekstin e krijimit të një platforme hapësinore për promovimin dhe zhvillimin e një identiteti të ri politik e kulturor, të ashtëquajturin "identitet jugosllav" (Hoxha, 2013, fq. 31).

Teoritë humaniste të modernizmit, në veçanti mbështeten në një historicizëm

bazë ku historia përfshin kohën si progres i vetë-konceptuar i shprehur me fjalë të tilla si paqja, prosperiteti, liria, barazia ose demokracia. Kështu, arkitektura shfaqet si një manifestim i një ose më shumë prej këtyre shprehjeve. Progresi modernist në mjediset kapitaliste merr formën e "zhvillimit", i cili përpunohet në "shkatërrim krijues", dhe i cili pastaj krijon shanse të reja për progres ekonomik. Në mjediset komuniste, siç ishte ish-Jugosllavia, zhvillimi modernist mori formën e "revolucionit" dhe potenciali i tij i shkatërrimit qëndronte në rolin e një motori për ndryshime revolucionare (Hoxha, 2013, fq. 26).

Për Kosovën, periudha e të ashtuquajturit "modernizëm socialist" në ish-Jugosllavi, nuk ka qenë vetëm një transformim në drejtim të zhvillimit të arkitekturës dhe qytetit, por ajo shënon fillimet e profesionit arkitektonik dhe urbanistik të organizuar dhe të udhëhequr nga profesionistët, duke përfshirë arsimimin e arkitektëve në shkolla të ndryshme arkitekturore në ish-Jugosllavi si dhe themelimi i shkollës së arkitekturës në Kosovë në vitet 70-të të shekullit të XX-të.

Në mjedise komuniste, "kontributi për përparimin" e Kosovës u kuptua në mënyra të ndryshme, ku qëllimi kryesor ishte për të ngritur Kosovën në një pozitë pothuajse të barabartë brenda pjesës tjetër të Jugosllavisë. Si duket ky "kontribut" u keqkuptua me një çlirim total të veprimeve të papërgjegjshme kundrejt strukturave tradicionale arkitekturore të cilat u prishën dhe u zëvendësuan me ndërtesa të reja. Si pasojë, kjo rezultoi nga synimi për një "përparim", në një humbje të identitetit. Për legjitimitimin e këtyre veprimeve padyshim që faji i'u bie arkitektëve "lokalë", por që përfshirja e tyre në këto procese ishte e kufizuar. Pavarësisht kësaj, nuk ka dyshim se ata vërtet dhanë një kontribut. Nëse asgjë tjetër, ata me siguri shtuan elementë që askush tjetër nuk mund t'i kishte shtuar, për t'i dhënë qyteteve të Kosovës pak nga shpirti i vendit (Jashari-Kajtazi, 2016, fq.11-12).

Shumica e qyteteve në territorin e ish-Jugosllavisë përqaftuan me kohë trendet globale, ndërsa Kosovës iu imponua një gjë e tillë, siç argumenton arkitekti Gëzim Paçarizi, por natyrisht që duhet theksuar se kjo nënkupton përmbartimisht imponimin politik i

cili solli me vete edhe imponimin e modernizmit sipas modelit ish-Jugosllav (Drenogllava, 2021, fq.15).

Në rastin konkret, Kosova synon gjetjen dhe pranimin e cilësive urbanistike e arkitektonike si dhe formave të tjera në zhvillimin e arkitekturës bashkëkohore, si nga racionalizmi skematik e deri te plasticizmi dinamik. Andaj, për Andrija Mutnjakovic është plotësisht i pranueshëm inspirimi tek elementet dhe detajet kombëtare, të cilën ai e quan si regjionalizëm nativ (Gjinolli & Kabashi, 2015). Natyrisht, regjionalizmi si qasje nuk është invencion i Mutnjakovic, por është qasje e pranuar postmoderne e që nënkupton përvetësimin e elementeve arkitektonike në nivel regjional, me ç'rast, me regjion mund të nënkuptojmë një zonë etnografike, si p.sh. Drenica, etj., apo një zonë më të gjerë gjeografike si Ballkani, koncepte për të cilat flasin edhe autorë të tjerë si Tzonis, Lefevre, etj. (Drenogllava, 2021, fq.15).

Duke parë zhvillimin e arkitekturës në territorin e ish-Jugosllavisë që nga Kongresi i Berlinit, luftërat Ballkanike dhe deri në dekadat e para të shekullit të XX-të, mund të thuhet se

karakterizohet nga folklori dhe arkitektura eklektike, por pas vitit 1930, filluan të shfaqeshin ndërtesa që manifestuan fuqimisht parimet e modernitetit në arkitekturë. Kështu, deri në shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore, moderniteti u vendos me shpejtësi si shfaqja dominuese e prodhimit arkitektonik, me të cilin nocioni i unitetit Jugosllav fitoi identitetin e tij përmes gjuhës universale dhe abstrakte, duke shkatërruar dallimet etnike e kombëtare (Sadiki, 2020, fq.17).

Është e qartë se qasja Sovjetike ishte hedhur poshtë si një model për arkitekturën e ardhshme në shoqërinë e sapo krijuar komuniste. Një qasje e tillë u ekspozua gjerësisht duke filluar me përkujtimet e Luftës së Dytë Botërore, në të cilën ne kurrë nuk gjejmë një përsëritje të butë të simboleve me të cilat LNÇ-ja ishte e lidhur, por gjithnjë drejtoheshin nga forma gjeometrike universale, të

cilat kishin më pak të bënin me shënime dhe glorifikime të rrepta të së kaluarës, dhe më shumë kishin të bënin me projeksionin e një të ardhme utopike (Stierli & Kulić, 2018, fq.169-172).

Në spektrin e arkitekturës, të gjitha republikat në Jugosllavinë socialiste krijuan sipas materialit të tyre të mundshëm shpirtëror dhe nuk duhet harruar që në një periudhë gjatë viteve '60-të e '70-të, të gjithë arkitektët u bënë mendimtarë dhe se "arkitektura e kësaj periudhe ishte e pastër dhe dinjitoze deri në përsosmëri" (Llonçari, 2004, fq.35). Arkitektura e kësaj periudhe ende nuk është vlerësuar si duhet e madje shpesh nënvlerësohet, edhe pse për Kosovën por edhe rajonin paraqet një shtresim të rëndësishëm kulturor, në një periudhë shumë të rëndësishme të zhvillimit shoqëror, pavarësisht se shumica e arkitektëve mund të mos ishin kosovarë (Jashari-Kajtazi, 2016, fq.45).



HAPËSIRAT PUBLIKE MODERNE NË KOSOVË

Thirrja për një qytet të përjetshëm që nuk ndryshon kurrë është një skenar utopik, pasi që çdo brez ka të drejtë të shpreh bindjet e tyre në hapësirën ku jeton. Kjo është pjesë e teorisë së padiskutueshme të zhvillimit të vazhdueshëm të qyteteve (Zukin, 2010, fq.1-32). Ky proces shpesh përshpejtohet nga katastrofa natyrore si tërmetet, ose të shkaktuara nga njeriu të tilla si luftërat. Qyteteve në Rajonin e Ballkanit në tërësi i ka munguar aftësia për të shmangur luftërat në të kaluarën e tyre e as qytetet në Kosovë nuk bëjnë përjashtim (Drenogllava, 2021, fq.14).

Pas LDB-së, autoritetet gradualisht deri në vitin 1960, shkatërruan një pjesë të konsiderueshme të objekteve të vjetra për t'u krijuar hapësirë ndërtesave të reja - moderne të burokracisë komuniste dhe hapësira të reja publike të lavdisë socialiste (Gjinolli, 2015, fq.169). Florina Jerliu, në tezën e saj të doktoraturës në Universitetin e Sarajevës, tregon që një sistem i ri vlerash socio-kulturore filloi të zhvillohet në këto rajone, por në kurriz të atyre të trashëguara, pavarësisht nga rëndësia, dallueshmëria, hapësira e dikurshme dhe dimensionin historik (Jerliu, 2014).

Në vendet socialiste, pjesa më e madhe e tokës ishte publike dhe pronësia private ishte e kufizuar, veçanërisht në zonat urbane. Hapësira publike në qytetet socialiste ndryshon nga ato të Evropës perëndimore kryesisht në tre aspekte (Gjinolli, 2015, fq.41):

1. Një përqindje e madhe e tokës është në shfrytëzim publik;
2. Shpërndarje dhe rrjet dukshëm i ndryshëm; dhe
3. Dallime të mëdha në dimensionin funksional.

Të gjitha rrugët, parqet dhe hapësirat publike u zhvilluan në tokën publike, zakonisht të fituar nëpërmjet shpronësimit për nevoja publike. Ndërtuesat institucionale u ndërtuan gjithashtu në tokë shtetërore ku shumica prej tyre përmbanin hapësirën e tyre publike, zakonisht e hapur për qytetarët. Socializmi solli disa forma të reja të tubimeve publike si shëtitjet në qytet gjatë mbrëmjeve, në të ashtuquajturën "korzo", e cila zakonisht zhvillohej në rrugët kryesore (Fig.1). Sporti dhe rekreacioni konsideroheshin ndër aktivitetet më të rëndësishme në jetën shoqërore të socializmit. Ndërsa shoqëria bëhej më e organizuar, shumëllojshmëria e lojë-



Fig. 1. Bulevardi "Marshall Tito" atëkohë,
sot bulevardi "Nënë Tereza" (web)

-rave sportive u bë më e pasur, kështu, pjesëmarrja e klubeve në ligat sportive të ish-Jugosllavisë solli njerëzit në stadione, një përvojë kjo krejtësisht e re e jetës publike (Beqiri & Navakazi, 2018, fq.102; Gjinolli, 2015, fq.173).

Hapësirat e reja publike erdhën si nevojë për të krijuar vende për monumentet e lavdisë për sistemin socialist. Gjatë festave kombëtare, organizoheshin tubime të imponuara nga autoritetet në sheshet kryesore, ku, zakonisht, fjalimet politike në lavdinë e shoqërisë komuniste përcilleshin me shfaqje muzikore dhe vallëzime të të ashtuquajturave shoqërive "kulturo-artistike". Këto vende ishin edhe vende grumbullimi për qëllime të ndryshme dhe për pushim gjatë shëtitjeve në qytet për të gjitha moshat dhe kombësitë (Gjinolli, 2015, fq.177).

Hapësirat publike kryesore të periudhës së Modernizmit në Kosovë padyshim ishin sheshet qendrore. Monumentaliteti i ngarkuar ideologjikisht i këtyre hapësirave, të dekoruara për "festimet" e duhura të udhëheqjes së lavdishme të Partisë Komuniste, i bëri që këto të qëndrojnë të zymta, në kon-

-trast me bollëkun e hapësirave të hapura ndonëse të rrëmujshe dhe të padiferencuara që karakterizon shumicën e peizazhit urban në qytetin socialist. Nën këto rrethana, ndërveprimi social mbeti i vetmi funksion praktik i publikut në hapësirë (Gjinolli, 2015, fq.173).

Në vitin 1974, Kosova mori statusin autonom në RSFJ, me pothuajse të gjitha të drejtat si republikat e tjera të ish-Jugosllavisë, përveç të drejtës së shpërbërjes. Kjo autonomi krijoi mundësi për një zhvillim të ri institucional me përparime edhe në fushën e planifikimit urban dhe arkitekturës, dhe u bë shtyllë për transformimin e qendrave të qyteteve duke përfshirë projektimin e shumë ndërtesave institucionale me hapësirat e tyre publike (Beqiri, 2018a, fq.10). Prej tyre dallojmë Pallatin e Rinisë dhe Sporteve, Pallatin e Shtypit "Rilindja", Radio "Prishtina", Qendrën Universitare duke përfshirë Bibliotekën Kombëtare, Shtëpinë e Kulturës në Gjakovë, Bankkosin në Pejë, Ndërtesën e Postës në Ferizaj, Motel "Trofta" në Istog, etj. Për sa i përket jetës publike, këto ndërtesa prezantojnë simbolet e prosperitetit dhe emancipimit të qytetarëve të Kosovës.

Këto ndërtesa, e shumë të tjera, sot konsiderohen si pika referimi të qyteteve përkatëse, megjithëse shumë prej këtyre objekteve dhe hapësirat publike rreth tyre janë transformuar tërësisht për shkak të ndryshimit të pronësisë ndër vite. Ky hulumtim, siç është kuptuar tashmë nga vetë titulli, është i përqëndruar në hapësirat publike moderne në Kosovë, me qëllim për të ngritur vetëdijen mbi rëndësinë e tyre, gjendjen ekzistuese dhe potencialet për përmirësimin e kualitetit të hapësirave përmes ndërhyrjeve urbane. Ndonëse ndërtesat moderne janë përfunduar dhe janë shfrytëzuar që nga koha e ndërtimit të tyre, hapësirat publike që në parim shoqërojnë pothuajse të gjitha ndërtesat e periudhës moderne në Kosovë, nuk arritën që të projektohen në tërësi dhe të kultivohen për një përdorim të duhur nga shoqëria. Nga vizitat në terren është kuptuar që për fat të keq, shumica prej tyre edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të jenë të mbeten të pashfrytëzuara tërësisht.

Me qëllim për t'a bërë më të qartë arsyen se përse në vazhdim të këtij kapitulli do të bëhet një lartësim i rëndësisë së objekteve të periudhës moderne në Kosovë, pavarësisht faktit




Fig. 2. Fotografi e vjetër e Hotel "Lybeteni" në Ferizaj (web)

që ky hulumtim ka në fokus hapësirat publike, duhet theksuar se është e vështirë të flitet për njërin pa e përfshirë edhe tjetrën. Ashtu siç është përshkruar në fillim të këtij kapitulli, hapësirat publike moderne janë pakushtimisht të lidhura me vetë objektet e modernizmit dhe është e pashmangshme që hulumtimi mbi rëndësinë historike e arkitektonike të tyre, analizat dhe vizionimi i hapësirave publike moderne, të konsiderojë hapësirat publike dhe ndërtesat si një tërësi dhe jo si elemente të ndara dhe të pavarura nga njëra-tjetra (Fig.3).



Fig. 3. Qendra e Rinisë dhe Sporteve e njohur dikur si "Boro e Ramizi" (web)



KOSOVA
42°35'0"N 21°0'0"E


CILAT HAPËSIRA PUBLIKE?

Ky hulumtim është në fakt vetëm një pikënisje për të ngritur vlerat e trashëgimisë së shekullit XX dhe arkitekturës moderne në Kosovë. Rrjedhimisht, janë përzgjedhur vetëm një numër i caktuar i hapësirave publike moderne, në mesin e një numri të madh hapësirash ekzistuese, me idenë që në hulumtimet e radhës të zgjerohet opusi hulumtues edhe me shumë raste të tjera. Me qëllim vlerësimin, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë moderne në disa nga qendrat kryesore të Kosovës, ky punim është përqëndruar në disa nga qytetet që karakterizohen me një numër më të madh të ndërtesave dhe hapësirave publike moderne në Kosovë, e që janë: Prishtina, Gjakova, Peja, Ferizaj, Gjilani dhe Istogu. Duke u bazuar në literaturën ekzistuese dhe vizitat në terren, nënkapitujt e radhës do të shpalosin vlerat e disa nga hapësirave publike më të rëndësishme në komunat e lartpërmendura.

Prishtina karakterizohet me numrin më të madh të ndërtesave moderne në Kosovë, megjithatë, në këtë hulumtim janë përzgjedhur hapësirat publike që shoqërojnë këto ndërtesa moderniste: Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, Ndërtesën e Parlamentit, Shtëpinë e Mallërave "Gërmia",

Ndërtesën e Bankës së Kosovës, Pallatin e Rinisë, Pallatin e Shtypit "Rilindja", Ndërtesën e Institutit Albanologjik, Fakultetin Teknik, Hotel "Grand", Radio "Prishtina", Ndërtesën e Bankës së Lubljanës, Hotel "Bozhuri", "Elektrokosova", Ndërtesën e Postës, Monumentin "Vllaznim-Bashkim", Kosova Film, Kompleksin e Kurizit, Mensën, Qendrën tregtare "Bregu i Diellit", Stacionin e Autobusëve, Trekëndëshin e Dardanisë, Ndërtesën e banimit në Bregun e Diellit dhe Galerinë Kombëtare të Kosovës.


Në Gjakovë janë përzgjedhur hapësirat publike rreth Ndërtesës së Banimit të Miodrag Pecić, Shtëpisë së Kulturës dhe Pallatit të Sporteve "Shani Nushi"; ndërsa në Pejë ato rreth Shtëpisë së Mallërave, Bankkos-it dhe Teatrit Profesionist të qytetit "Istref Begolli". Ndër hapësirat publike moderne në Ferizaj janë përfshirë ato të Pallatit të Sporteve "Bill Clinton", Stacionit Policor, Ndërtesës së Postës, Bankkos-it, Hotel "Lybeteni" dhe Ndërtesës Administrative të Komunës. Në komunën e Gjilanit janë identifikuar Shtëpia e Mallërave dhe Rrokaqielli të Miodrag Pecić, përderisa qyteti i Istogut përfaqësohet me një nga projektet më të rëndësishme moderne në Kosovë, Motelin "Trofta".



PRISHTINA

42°39'48"N 21°9'44"E


BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS



Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës erdhi si ndikim i drejtëpërdrejtë i rrethanave shoqërore të kohës, dhe si funksion e simbolikë është padyshim e lidhur me themelimin dhe zhvillimin e Universitetit të Prishtinës. Ndërtimi përfundoi në vitin 1982, projektuar nga arkitekti dhe publicisti nga Zagrebi Andrija Mutnjaković. Është e vendosur në qendër të Qendrës Universitare, sipas planit të Bashkim Fehmiut, koncepti i hapësirës arkitektonike i të cilit ishte kubi dhe gjysëmshfera, duke nxitur kështu Mutnjaković që konceptin e dizajnit të bibliotekës ta zhvillojë mbi idenë e një kubi të ndriçuar nga lartë përmes një kupole. Ai i kthehet elementeve të regjionalizmit, trashëgimisë dhe arkitekturës vernakulare, për të bërë një ndërlidhje më të mirë mes të resë dhe strukturës urbane ekzistuese dhe për të ofruar lidhjen e ndërtesës me banorët (Beqiri, 2018b, fq.23-25).

Mutnjaković insistonte në përfshirjen e komponentës njeri, me të gjitha doket, traditat regjionale, mënyrat e mendimit dhe individualitetet lokale. Kupola ka për qëllim ndriçimin natyror të hapësirave të leximit të përkrahur edhe me ndriçimin nga fasada prej qelqit nga dyshemeja në plafon, e cila është e mbuluar me një strukturë në formë heksagonale nga shiritat e aluminit të lidhura mes vete, duke krijuar kështu një rrjetë si një lloj maske për të zbutur shkëlqimin dhe për të shmangur ndikimin negativ të dritës. Tërësia kompozicionale e kubave dhe kupolave të shpërndara në mënyrë dinamike brenda një rrjeti modular, rezulton në një tërësi të përkryer e cila sa është tradicionale si motiv, aq është edhe bashkëkohore si material dhe teknologji e ndërtimit (Jashari-Kajtazi, 2016, fq. 27-38, Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.96; Sadiki, 2020, fq.102-105).

Ndërtesa e Bibliotekës është e rrethuar me një hapësirë publike të gjerë, me një potencial të madh shfrytëzueshmërie, e cila e shtrirë në terrenin e pjerrët ndërlidh pjesë të ndryshme të Kampusit Universitar. Hapësira e gjelbërt që e rrethon, së bashku me mobiliarin ekzistues, shfrytëzohen jo vetëm nga studentët por edhe të gjithë kalimtarët dhe grupet tjera të shoqërisë, ndërsa shkallarët publikë në anën e hyrjes kryesore të objektit i'a shtojnë monumentalitetin ndërtesës së Bibliotekës dhe e komplettojnë projektin origjinal të arkitektit.




NDËRTESA E INSTITUTIT ALBANOLOGJIK

SHTËPIA E MALLËRAVE "GËRMIA"

Ndërtesa e Institutit Albanologjik u ndërtua në vitin 1977 nga arkitekti Miodrag Pecić, në kuadër të Qendrës Universitare të Universitetit të Prishtinës. Është e ndërlidhur në mënyrë të jashtëzakonshme me topografinë, duke manifestuar një simbiozë të shkëlqyer me ambientin që e rrethon, ndërsa përdhësia e lirë mundëson një qarkullim më të lirë dhe një ndërlidhje organike me ndërtesat tjera të kampusit. Shtrirja, vëllimet e ndërtesës, materialet e përdorura dhe hapësira publike e integruar në të krijojnë identitetin e ndërtesës. Parapetët e pjerrtë përgjatë fasadës janë element identifikues, që përveç funksionit, përmes lojës së dritës dhe hijes dhe së bashku me gjelbërimin në hapësirën publike, mundësojnë një intimitet dhe përjetim ndryshe të ndërtesës (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.90; Sadiki, 2020, fq.68).

Ndërtesa është projektuar në vitin 1970 dhe është e para tipologji e tregtisë në një planimetri të tipit të hapur, që solli të parët eskalatorë në qytet. E gjithë përmabjtja e ndërtesës është futur në mënyrë racionale brenda një kutie drejtëkëndore masive, që është dinamizuar në dy fasada përmes elementeve të kuadrantit të fasadës metalike që është përdorur si mbështjellës i volumit monolit. Dy fasadat tjera janë materializuar me brut beton, me një teksturë dhe plastikë të shkallëve të jashtme që i japin një poetikë të jashtëzakonshme ndërtesës (Sadiki, 2020, fq.77). Përdhësia e tejdukshme mundëson një komunikim të mirë me sheshin "Skëndërbeu", si funksionalisht ashtu edhe estetikisht, duke dhënë përshtypjen se ndërtesa është vendosur me lehtësi dhe delikatesë në lokacion. E lidhur në mënyrë direkte me sheshin në anën lindore të ndërtesës, është një nga hapësirat publike me gjallërinë dhe fluksin më të madh të lëvizjes në qytet.

NDËRTESA E BANKËS SË KOSOVËS




Ndërtesa e Bankës së Kosovës u ndërtua nga arkitekti sarajevas Halid Muhasilović, me lokacion në mes të tre ndërtesave të rëndësishme të qytetit: hoteli "Grand", Pallati i Shtypit dhe "Boro dhe Ramizi". Dy etazhat e para të ndërtesës janë të tërhequra në brendi dhe të materializuara me fasadë qelqi të pandërprerë, ndërsa dy etazhet e sipërme dalin konsull mbi ato të poshtmet, duke i dhënë kështu ndërtesës një ekspresivitet të theksuar. Komunikimet vertikale janë trajtuar me materiale të vrazhda, duke krijuar kështu kontrast me fasadën e qelqit dhe duke u manifestuar si katër shtylla gjigande të mbajnë tërë volumnin masiv të ndërtesës. Kjo lojë dhe kompozicion arkitektik rezulton me një ndërtesat më cilësore me elemente të theksuara të konstruktivizmit në qytet (Sadiki, 2020, fq.82).


Për sa i përket hapësirës publike pranë Ndërtesës së Bankës së Kosovës, në anën veriore të saj shtrihet parku "Heroinat", i cili i vendosur mes tri ndërtesave të njohura të periudhës moderne, ofron një hapësirë të qetë në mesin e kaosit urban të kryeqytetit. Si pasojë e ndërhyrjeve urbane të viteve të fundit, ky park shfrytëzohet nga të gjitha grupmoshat e shoqërisë, e në veçanti fëmijët edhe adoleshentët të cilët e shohin si hapësirë të përshtatshme për lojë dhe patina.

PALLATI I RINISË (BORO DHE RAMIZI)

Qendra sportive dhe rekreative "Boro dhe Ramizi" u projektua nga një grup arkitektësh, me në krye profesorin dhe arkitektin sarajevas Živorad Janković. Në kontekst urban, është një hapësirë publike e mbyllur dhe e hapur që është gjithmonë vibrante, e që me qasjen dhe zgjidhjen funksionale, mundëson shfrytëzim maksimal të të gjitha hapësirave nga sportistët dhe publiku. Duke u shkrirë me dispozitat urbane, kjo i ofron qendrës së qytetit hapësira kualitative me ndikim në gjithë qytetin. Konsiderohet si arkitekturë moderne funksionaliste, meqenëse madhësia, vëllimi, materialet dhe gjuha arkitektonike i janë nënshtruar tërësisht funksioneve të kulturës, sportit dhe rekreacionit. Kjo ndërtesë dominohet nga struktura e fuqishme me kapriatë hapësinore prej çeliku në formë të brinjëve e mbuluar me llamarinë bakri dhe fasada transparente e qelqit që jep përshtypjen e lehtësimit të strukturës dhe perceptimin si një ndërtesë publike e hapur për të gjithë. Tratë masivë të kulmit, përpos rolit konstruktiv, lexohen si elemente kryesore të kompozicionit arkitektonik, duke i dhënë ndërtesës një ekspresivitet dhe dominancë të pamatshme në siluetën e qytetit (Jashari-Kajtazi, 2016, fq.118-123, Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.98; Sadiki, 2020, fq.54-61).



FAKULTETI TEKNIK




Fakulteti Teknik filloi të ndërtohej në vitin 1977, në bazë të idesë së arkitektit Edvar Ravnika, me projekt kryesor të zhvilluar nga "Invest Buro" dhe arkitekt përgjegjës Rajko Džankić. Propozimi i Ravnika shfrytëzonte rënien e theksuar të terrenit, ku volumet e secilës njësi funksionale ishin të lidhura mes vete duke mundësuar lidhje të pashkëputur në mes hapësirave ku mbahej mësimi teorik me atë laboratorik. I tërë kompleksi kishte një fleksibilitet funksional të jashtëzakonshëm, ku secila njësi ishte pjesë e pandarë e tërësisë, e në të njëjtën kohë mund të funksiononte edhe plotësisht e pavarur. Për fat të keq, vetëm 25% e kompleksit të projektuar u realizua, duke humbur kështu kuptimin e qasjes konceptuale të arkitektit, në aspektin funksional, estetik e formësues.

Ndërtesa e Fakultetit Teknik u materializua me natur beton dhe volumi kryesor drejtëkëndor i ndërtesës karakterizohet me trarëzat që përsëriten në secilin nivel të fasadës, që e pasurojnë atë me plasticitet dhe monumentalitet (Sadiki, 2020, fq.114-115).

Ndonëse e rrethuar me hapësira publike të gjelbërta në të gjitha anët, pjerhtësia e terrenit, mungesa e mirëmbajtjes dhe mungesa e mobiliarit urban adekuat e pamundëson shfrytëzimin e hapësirës nga studentët apo shfrytëzuesit e tjerë. Përveç hapësirës në hyrje të ndërtesës dhe parkingut të cilat shohin një qarkullim më të madh të njerëzve, mungesa e shtigjeve për këmbësorë bën që shumica e hapësirave të gjelbërta përreth të jenë të paqasshme për këmbësorë. Shkallët që të shpiejnë në ndërtesë nga rruga "Agim Ramadani", ndonëse një element identifikues i hapësirës dhe i patjetërsueshëm për qasjen në ndërtesë, për shkak të mungesës së mirëmbajtjes po bëhen gjithnjë e më shumë vështirë të kalueshme nga studentët dhe punonjësit e Fakultetit.

MENSA E STUDENTËVE




Ndërtesa e Mensës së Studentëve është ndërtuar në vitin 1974, me projekt të arkitektit Dragan Radulović, në vazhden e zgjerimit të Qendrës Universitare. E vendosur në një topografi dinamike, në kryqëzimin e dy prej rrugëve kryesore të cilat lidhin katër anët e qytetit, ajo imponohet me praninë e saj në hapësirë. Fasada transparente veri-perëndimore i'u ofron studentëve në sallën kryesore të Mensës të kenë para vetes tërë peisazhin urban të qytetit. Ndërtesa karakterizohet për nga formësimi arkitektonik, theksimi i elementeve konstruktive të materializuar me brut beton, përdorimi i kulmit me pjerrtësi të lehtë dhe figurat gjeometrike të vendosura tek rrethojat e ballkoneve të objektit. Vendosja e ndërtesës me

mjeshtri në pjerrtësinë e terrenit mundëson një shkrirje të saj në lokacion, duke rezultuar në një ndërtesë të jashtëzakonshme të arkitekturës moderne në Prishtinë, e cila i jep frymë dhe energji rinore gjithë qytetit (Sadiki, 2020, fq.70).

Hapësirë publike pranë ndërtesës së Mensës konsiderojmë përdhësën e lirë në hyrje të objektit dhe hapësirat e gjelbërta që e rrethojnë, së bashku me shkallët në anën veriore, jugore dhe perëndimore të saj. Duke qenë se përdhësia e lirë është një urë-lidhëse mes Kampusit Universitar dhe Qendrës Universitare, kjo hapësirë publike vizitohet nga qindra studentë çdo ditë, edhe pse shumica e tyre e shfrytëzojnë si transit për të kaluar nga njëra anë në tjetrën. Pavarësisht kësaj, kualiteti i hapësirës dhe fluksi i madh i kalimtarëve janë vetëm disa nga përparësitë që e karakterizojnë këtë hapësirë publike, e cila ka potencial të madh për intervenime urbane.

PALLATI I SHTYPIT "RILINDJA"



Ndërtesa e Pallatit të Shtypit "Rilindja" u projektua nga arkitekti shkupjan Georgi Konstantinovski në vitin 1972, e cila me strukturën dhe vëllimin e saj dominon qendrën e qytetit modern të Prishtinës. Arkitektura e ndërtesës nga betoni natyror i takon modernizmit internacional me tipare të brutalizmit në arkitekturë, ku elementet e betonit të ngjyrosura me të bardhë krijojnë një larmi vizuale në fasadë. Kompozicioni i ndërtesës përbëhet nga tri volume të veçanta, të cilat manifestojnë ekspresivitet të jashtëzakonshëm hapësinor dhe me energjinë e tyre ndikojnë në të gjithë qytetin. Volumi i pastër drejtëkëndor i lartë 72 metra pasuron siluetën e qytetit me një lehtësi dhe elegancë të një kryevepre të pakrahueshme. Plani i organizuar rreth

bërthamës, në një dispozitë të lirë dhe fleksibile të organizimit të punës së gazetarisë dhe veprimtarisë botuese lejoi që kjo ndërtesë të adaptohej me lehtësi për një funksion të ri të administrates, siç ishte Qeveria e Kosovës, duke fshirë kështu fatkeqësisht një periudhë historike të arkitekturës moderne (Jashari-Kajtazi, 2016, fq.112-116, Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.82-83; Sadiki, 2020, fq.110-112). Pallati i Shtypit gëzon një hapësirë publike të gjerë në anën lindore të tij, në pjesën e hyrjes kryesore, e cila karakterizohet me një gjelbërim të theksuar që i ofron intimitet dhe qetësi hapësinor. Pjesët e gjelbërimit pranë ndërtesës janë më të mirëmbajtura në raport me ato më larg, megjithatë, hapësira në përgjithësi nuk shfrytëzohet nga publiku, pavarësisht potencial të madh që ka.

NDËRTESA E PARLAMENTIT TË KOSOVËS


Ndërtimi i ndërtesës së Parlamentit të Kosovës kishte filluar në vitin 1948 nga arkitekti beogradas Bogdan Nestorović, mirëpo, meqenëse ndërtesa nuk shprehte arritje kualitative artistike dhe arkitektonike, në vitin 1960, arkitekti sara-jevas Juraj Neidhardt u angazhua për rekonstruimin, adaptimin dhe zgjerimin e ndërtesës, të cilin ai e zhvilloi mbi parimet e arkitekturës moderne. Ai përdori forma të pastra gjeometrike, ku dominonin masat horizontale, me përdhësën e vendosur mbi shtylla, që nuk e ndërpriste lëvizjen e qytetarëve dhe zbuste egërsinë e ndarjes radikale mes hapësirës së brendshme dhe asaj të jashtme.

Në intervenim ishin lehtë të lexueshme parimet e Le Corbusier si: lehtësia e vendosjes së volumeve në lokacion, volumet e pastra gjeometrike, dritaret vertikale dhe kulmi i rrafshët. Përpos simbolikës arkitektonike në terma estetik, ndërtesa kishte edhe një simbolikë të prezantimit të qendrës së fuqisë vendimarrëse për të ardhmen e shoqërisë së orientuar ideologjikisht drejt modernitetit. E vendosur në zemër të qytetit, aty ku dikur ka qenë qendra historike e tij, ndërtesa kufizohet nga dy hapësira publike mjaft të frekuentuara dhe të shfrytëzuara: sheshi "Skënderbeu" dhe sheshi "Vllaznim-Bashkim". Për shkak të funksionit të ndërtesës, hapësirat e gjelbërta përreth saj janë të rrethuara me gardh dhe nuk shfrytëzohen. (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.38-39; Sadiki, 2020, fq.44-47).



Fig. 4. Maketa e Ndërtesës së Këshillit Ekzekutiv (Gjinolli & Kabashi, 2015)


NDËRTESTA ADMINISTRATIVE "ELEKTROKOSOVA"



Ndërtesa administrative "Elektrokosova" u projektua në vitin 1977 nga arkitekti Dragan Kovačević, pjesë e byrosë projektuese "Invest Buro", si një administratë e organizuar mirë, për të kryer me sukses shërbimet administrative të potencialit të jashtëzakonshëm energjetik që kishte Kosova në kohën e ish-Jugosllavisë. Ndërtesa përbëhet nga dy volume, atij horizontal në dy etazhat e para, për kontakt me klientët, që funksionon përmes sporteleve të organizuara në formë të planit të hapur, dhe atij vertikal që zhvillohet në formë të kullës, ku janë të vendosura zyret e mbyllura. Këto dy volume përbëjnë kompozicionin arkitektonik, ku masa horizontale balancon ndërtesën dhe shërben si platformë për vendosjen e kullës vertikale, e cila më pas i'a shton monumentalitetin objektit (Jashari-Kajtazi, 2016, 130-132, Sadiki, 2020, fq.89). Hapësira publike e kësaj ndërtese konsiston në hapësirën e gjelbërt në anën perëndimore të saj, e cila nuk shfrytëzohet, si dhe shkallët që të shpiejnë në hyrje të ndërtesës në anën veriore të cilat i japin akoma më shumë monumentalitet objektit dhe kanë potencial për të përfaquar ide të ndryshme të ndërhyrjeve urbane.

HOTEL "GRAND"

Hoteli "Grand" i ndërtuar në vitin 1978, është një ndërtesë e rëndësishme e Bashkim Fehmiut dhe arkitektëve beogradas Miša Jevremović dhe Dragan Kovačević. "Grand"-i është një ndërtesë me rëndësi kombëtare dhe vëlletet e përbëra të tij tregojnë vazhdimësinë e temave të arkitekturës moderne të viteve të 60-ta, siç janë ndarjet vertikale në fasadë, variacionet në konstruksion, artikulimet horizontale në fasada, terracat dhe platformat që lidhen me hapësirat publike të qytetit. I pozicionuar në hyrje të Bulevardit "Nënë Tereza", në qendër të qytetit, ndërtesa është e vendosur me shumë vëmendje në raport me karakteristikat ekzistuese urbane dhe dispozitat zhvillimore, duke krijuar përreth vetes një hapësirë publike shumë vibrante dhe premtuese. Silueta e ndërtesës, organizimi dhe kompozimi i volumeve të saj dhe materialet e përdorura i japin asaj karakter dhe identitet me të cilin ajo krijon një ndërtesë dominante në qendrën e Prishtinës, si dhe ndikon në krijimin e fizionomisë së përgjithëshme të kësaj pjese të qytetit (Beqiri, 2021, fq.8; Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.86; Sadiki, 2020, fq.74).







Fig. 5. Motive nga Prishtina, Radio "Prishtina" (web)

RADIO "PRISHTINA"




E ndërtuar në vitin 1945, ndërtesa e Radio "Prishtina" është e një rëndësie të veçantë në këtë përblehdje, për shkak të rëndësisë shoqërore që e gëzonte nga natyra funksionale e ndërtesës, e që ishte mundësia për të shpërndarë informata dhe materiale me përmbajtje jo vetëm kulturore. Ndërtesa poashtu përfaqëson tendencën e zgjerimit të qytetit përtej bulevardit kryesor të qytetit të deriatëhershëm. Volumi horizontal i objektit është i materializuar me brut beton me teksturë relievi të dhëmbëzuar, duke manifestuar kështu ekspresivitet të theksuar. Ky volum ngritet gradualisht në lartësi, duke krijuar volumin vertikal

të materializuar me brut beton me teksturë të lëmuar, i cili jep një elegancë dhe i shton ndërtesës prezencën në lokacion (Fig.5). Tërësia kompozicionale e balancuar në aspektin gjeometrik, por edhe kontrasti i materialeve, ekspresivitet - elegancë, manifestohen në hapësirë në mënyrë mjaft poetike (Sadiki, 2020, fq.65).

Për fat të keq hapësira publike moderne që e rrethon këtë ndërtesë kryesisht shfrytëzohet nga punonjësit e mediave që janë të vendosura në objekt, e rrallë nga pjesa tjetër e shoqërisë. Pjesa më e madhe e hapësirës përdoret për parkimin e automjeteve të të punësuarve, përderisa pjesa tjetër shfrytëzohet vetëm si transit apo është e pamirëmbajtur dhe e paqasshme. Pavarësisht potencialit të madh që ka dhe lidhjes së afërt me Kampusin Universitar në lindje, rrethimi i ndërtesës me gardh e ndan atë nga tërësia e hapësirave publike që e rrethojnë.

HOTEL "BOZHURI"





Ndërtesa e hotelit "Bozhuri i Kosovës" u ndërtua pas Luftës së Dytë Botërore, e cila e vendosur në qendër të qytetit dhe e rrethuar me ndërtesa të rëndësishme shoqërore, paraqiste një pikë referimi ku manifestoheshin të gjitha ndryshimet rrënjësore në marrëdhëniet shoqërore të kohës. Ndërtesa përbëhet nga dy volume, ai horizontal, ku gjenden holli hyrës, restoranti dhe hapësirat tjera përcjellëse, dhe ai vertikal, ku janë të organizuara dhomat. Volumi horizontal është trajtuar me hapje të mëdha prej qelqit dhe është më pak dominues në krahasim me atë vertikal, i cili bën kontrast me materialin e plotë dhe lartësinë e tij, duke i dhënë kështu hotelit një prezencë më të madhe vizuale (Sadiki, 2020, fq.72). Përveç shpërfytyrimit që i është bërë fasadës së ndërtesës, transformim ka pësuar edhe hapësira publike pranë Hotel "Bozhuri", të cilën sot nuk e gjejmë në gjendjen burimore për shkak të ndryshimeve të ndodhura në Bulevardin "Nënë Tereza".

NDËRTESA E BANKËS SË LUBLJANËS

Ndërtesa e Bankës së Lubljanës u projektua në vitin 1984, si seli e Bankës së Lubljanës në Prishtinë, e përcaktuar si një ndërtesë e tipit rrokaqiell, me qëllim për të treguar edhe ajo prezencën dhe fuqinë financiare, meqenëse ndodhej pranë Bankës së Kosovës e cila dominonte me lartësinë dhe elegancën e saj. Paraqet ndërtesën e parë në qytet me tipologjinë e planit të organizuar përmes bërthamës e komunitit vertikal në qendër, dhe pjesën tjetër të planit përreth të lirë, pa ndarje. Përfundimet harkore në pjesët ballore të materializuara me fasadë strukturale dhe ngjyra e gjelbër reflektojnë një elegancë të tërësisë kompozicionale të ndërtesës, duke e shndërruar atë në një atraksion të vërtetë të kohës (Jashari-Kajtazi, 2016, fq.124-129, Sadiki, 2020, fq.90).

Duke qenë se ndërtesa është e vendosur në udhëkryq, e tangjuntuar nga rrugët "Fehmi Agani" në jug dhe "Migjeni" në lindje, hapësira publike që i takon ndërtesës është e kufizuar. Në këtë rast hapësira publike moderne konsiston nga hapësira e lirë përpara hyrjes kryesore, e cila shpesh shfrytëzohet për pritje nga përdoruesit e ndërtesës dhe është gati gjithmonë e kapluar nga fluksi i madh i njerëzve që kalojnë në këtë pjesë shumë të gjallë të qytetit.





NDËRTESA E POSTËS


Ndërtesa e Postës është një prej ndërtesave të rëndësishme të viteve të tetëdhjeta në Prishtinë, e cila lidhi qytetin me rrjetin lokal, regjional e ndërkombëtar të botës së telekomunikacionit (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.48). Të vendosur në një terren me pjerrtësi të theksuar, dy volume me lartësi 47.6 metra dhe 40.8 metra, ndonëse janë të shmangura pak në pozitën e tyre në plan, plotësojnë njëri-tjetrin në kompozicionin e përgjithshëm hapësinor. Këto volume karakterizohen me veshjen përgjatë gjithë lartësisë së tyre me qelq dhe këndet e trajtuara me mure masive, që i japin elegancë siluetës së kryeqytetit (Sadiki, 2020, fq.88).

E rrethuar me një hapësirë publike për shfrytëzim vetëm nga këmbësorët, kjo ndërtesë karakterizohet me gjelbërimin e shumtë që e rrethon dhe shkallët karakteristike në anën veriore të saj. Intervenimet në mobiliarin urban dhe dyshtemenë urbane të cilat janë ndërmarrë gjatë viteve të fundit i kanë shtuar akoma më shumë kualitet hapësirës, përderisa prezenca e njerëzve në hapësirë nuk mungon asnjëherë, për shkak të lidhjes së ndërtesës me Kompleksin e Kurrizit i cili njihet tashmë për gjallërinë që e veçon.



MONUMENTI "VLLAZNIM-BASHKIM"


Obelisku trerremësh kushtuar të rënëve të Luftës Nacional Çlirimtare, monumenti "Vllaznim-Bashkim" nga skulptori Miodrag Živković, u vendos në sheshin "Vllaznim-Bashkim" të projektuar nga arkitekti Miodrag Pecić gjatë viteve 1959-1961. Mbështetja e tre elementeve vertikale në njëri-tjetrin simbolizonte mbështetjen e tri entiteteve kryesore të Kosovës, në ndërtimin e së ardhmes së përbashkët. Ky obelisk ishte formësuar të komunikonte ide të rendesishme kulturore, duke përfaqësuar simbolin e qytetit dhe shoqërisë vetëqeverisëse. I vendosur në një prapavijë historike, që dominohej nga tri minaret e xhamive të periudhës së Perandorisë Otomane, monumenti tregon se në qytet po vinin simbole të reja dhe simbolizonte dorëheqjen nga e kaluara dhe orientimin nga e ardhmja moderniste (Sadiki, 2020, fq.42). Sot sheshi "Vllaznim-Bashkim" është një hapësirë publike shumë ftuese për të gjitha grupmoshat e shoqërisë, ku mobiliari i ri urban, së bashku me gjelbërimin e pasur që e karakterizon, krijojnë një hapësirë atraktive për të gjithë kalimtarët dhe shfryzëtuesit e saj.



KOMPLEKSI I KURRIZIT

Në frymën e kohës dhe nën influencën e planit urbanistik të Shkupit, i punuar nga arkitekti Kenzo Tange, Kompleksi i Kurrizit (1972-1978) është një lagje e tërë që paraqet një grupim heterogjen dhe një megastrukturë unike me ide radikale të ndarjes së këmbësorëve nga automjetet. Kjo ndarje është arritur duke ngritur përdheshën e blloqeve të banimit në një platformë për këmbësorë dhe duke vendosur rrugët në nëntokë, në nivel të terrenit. Ndërtesat e banimit mbi platformë janë të përmasave të mëdha, deri në pesëmbëdhjetë kate dhe janë karakteristike e lagjes (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.32-33).

Platoja për këmbësorë e Kompleksit është një hapësirë publike e njohur historikisht për fluksin e madh të njerëzve që ka mbledhur. Sot, pas transformimeve të ndryshme që kanë ndodhur ndër vite, intervenimet në kualitetin e dyshemesë urbane, mobiluarin urban, si dhe shtimi i mënyrave të reja të përdorimit të hapësirës i jep akoma më shumë gjallëri Kompleksit dhe e bën atë akoma më atraktiv për t'u shfrytëzuar nga banorët e lagjes dhe vizitorët apo kalimtarët tjerë.




NDËRTESE BANIMI BREGU I DIELLIT


Ndërtesat e banimit në lagjen Bregu i Diellit, të ndërtuara në vitin 1976, ilustronë ndërtimet e banimit të kohës, të cilat janë të ngjashme me ato në lagjen "Dardania", por me dendësi dhe shkallë më të ulët dhe jashtë qendrës. Darko Kozjak është autor i projektit fitues në konkursin për lagjen Bregu i Diellit, ndërsa së bashku me arkitektët nga zyrja Plan janë hartues të planit urbanistik dhe kanë punuar në projektimin e shumicës së ndërtesave të banimit në Prishtinë (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.43). Ashtu sikurse shumica e ndërtesave të banimit në periudhën në fjalë, edhe ndërtesat në lagjen "Bregu i Diellit" gëzojnë një hapësirë të pasur publike, me shumë gjelbërim, shtigje të mobilitetit dhe lojëra për fëmijë, që krijojnë ambiente kualitative për tu shfrytëzuar nga banorët e lagjes dhe vizitorët e tjerë.

QENDRA TREGTARE "BREGU I DIELLIT"

Qendra tregtare "Bregu i Diellit" u projektua nga arkitektët Sali Spahiu dhe Hamdi Binaku në vitin 1989, të cilët treguan mjeshtërinë e tyre të realizimit të ndërtesës në një pjertrësi të theksuar. Objekti karakterizohet me format gjeometrike të përdorura për kompozicionin e përgjithshëm, përzgjedhjen e materialeve, vendosjen e elementeve volumetrike lineare përgjatë gjatësisë së izohipseve të lokacionit, duke i lidhur ata gradualisht me shkallët dhe platotë sipas topografisë, ndriçimin zenital përmes llanternës cilindrike prej leksani dhe fasadën e veshur me materiale poliestere. Përveç zgjidhjes funksionale, ndërtesa gëzon kualitete shumë të mira të hapësirës publike përreth, përmes platove të jashtme si një urë lidhëse mes pjesës së poshtme perëndimore dhe asaj të sipërme lindore të lagjes "Bregu i Diellit" (Sadiki, 2020, fq.91).



KOSOVA FILM



Ndërtesa e Kosovafilmit është realizuar në Prishtinë nga arkitekti Sali Spahiu në vitin 1986, me qëllim zgjerimin e infrastrukturës kulturore; dhe me këtë ndërtesë, Salihu u shpërblye me çmimin për arkitekturë "Borba", për veprën më të mirë arkitektonike të realizuar në Kosovë gjatë vitit 1987. Kjo ndërtesë trekatëshe, e ndriçuar në mënyrë zenitale në mes kateve, tenton t'i integrojë hapësirat në një tërësi koherente, ndërsa përdhësa merr rolin e një hapësire publike për organizimin e manifestimeve të lidhura me filmin. Është e punuar me fasadë të parafabrikuar nga llamarina e plastifikuar, e cila shpreh karakterin e ndërtesës, ndërsa ngjyra portokalli bën kontrastin me mjedisin natyror përreth (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.104). Ndërtesa është e përshtatur në topografinë e terrenit dhe peisazhin ekzistues, ashtu që kuboidët, në mënyrë të shkallëzuar lëshohen në nivele të ndryshme varësisht pjerrtësisë së terrenit ekzistues (Sadiki, 2020, fq.62). Në vitet 1990-1999 nuk janë prodhuar filma e as nuk janë zhvilluar aktivitete të lidhura me filmin, ndërsa nga qershori i vitit 1999, ndërtesa shfrytëzohet si ndërtesë administrative në kuadër të bazës ushtarake të KFOR-it, rrjedhimisht hapësira publike që e rrethon nuk është e qasshme apo e shfrytëzueshme nga qytetarët (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.104).

GALERIA KOMBËTARE E KOSOVËS

Galeria Kombëtare e Kosovës u ndërtua përafërsisht në vitin 1935, si një njësi ushtarake e Ushtrisë Jugosllave, ndërsa gjatë viteve 1955-1981 vepronte si bibliotekë. Në vitin 1979, u themelua si institucion kulturor për prezentimin e artit pamor dhe ruajtjen dhe mbledhjen e veprave me vlerë. Ky institucion ka organizuar me qindra ekpozita në vend dhe jashtë, të cilat janë përcjellë me botime dhe me blerjen e shumë veprave artistike, duke formuar kështu një fond të pasur të Galerisë. Fasada e Galerisë është mjaft karakteristike dhe është e ndërtuar nga guri i zonës së Pejës (Wikipedia, 2020).


Hapësira publike që e rrethon ndërtesën në anët veriore, jugore dhe perëndimore, është e shndërruar në hapësirë për parkimin e automjeteve, ndërsa disa pjesë më të vogla pranë ndërtesës janë hapësira të gjebërta. Ky fakt, së bashku me mungesën e mobiluarit urban dhe mirëmbajtjes së duhur, ndikojnë që kjo hapësirë të jetë më pak e shfrytëzuar në krahasim me hapësirat tjera publike të Kampusit Universitar pranë saj.

STACIONI I AUTOBUSËVE

Ndërmarrja Publike "Stacioni i Autobusëve" në Prishtinë është themeluar në vitin 1977, ndërsa në objektin ekzistues u vendos në vitin 1983, pasi ndërtimi i objektit të Stacionit të Autobusëve kishte filluar në vitin 1982. Pas përfundimit të luftës, në vitin 1999, ndërmarrja është administruar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), ndërsa që në vitin 2015 është shndërruar në ndërmarrje publike komunale, e organizuar si shoqëri akcionare, me Kuvendin Komunal të Prishtinës si pronar të ligjshëm të ndërmarrjes (NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë, 2019). Ashtu sikurse shumica e ndërtesave të periudhës moderne në Kosovë, edhe kjo ndërtesë gëzon hapësirën e saj publike karakteristike. Hapësira publike pranë Stacionit të Autobusëve është e pasur me gjelbërim dhe mobiliar urban, e në parim shfrytëzohet nga udhëtarët për pritje, ndonëse jo për periudha shumë të gjata.

TREKËNDËSHI I DARDANISË

Plani urbanistik Trekëndëshi i Dardanisë është punuar nga arkitekti zagrebask Dražen Janković, së bashku me kolegët e zyrës Plan në vitin 1972, dhe ky projekt ka orientuar në mënyrë të veçantë zhvillimin e qytetit. Në Prishtinë, platformat për këmbësorë, si hapësirë publike, janë temë kryesore urbanistike që ofrojnë momente interesante të perceptimit të qytetit nga perspektiva të ndryshme. Ndonëse mirëmbajtja është e dobët, lëvizja nëpër platformë dhe nëpër tunelet e ndriçuara në mënyrë zenitale të Dardanisë, paraqesin një përvojë të jashtëzakonshme për banorët dhe qytetarët (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.33).




GJAKOVA


42°23'0"N 20°26'0"E

NDËRTESEË BANIMI

Ndërtesa e banimit në Gjakovë, nga arkitekti nga Prishtina Miodrag Pecić, është një ndërtesë e rëndësishme e arkitekturës moderne në Kosovë, jo vetëm për shkak të interpretimit të elementeve regjionale por edhe për shkak të shkathtësisë së artikulimit në formë dhe kompozicionin e volumeve. E ndërtuar në vitin 1978, kjo ndërtesë është artikuluar në mënyrë strukturaliste dhe është vepër tikipe dhe shumë elegante e kohës (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.34). Hapësira publike që i takon kësaj ndërtesë të banimit është e shfrytëzuar pjesërisht për parkimin e automjeteve të banorëve të ndërtesës, përderisa pjesë të tjera janë hapësira të gjelbërta të cilat kryesisht shfrytëzohen nga banorët e lagjes.



SHTËPIA E KULTURËS




Shtëpia e Kulturës në Gjakovë, e ndërtuar në vitin 1976, nga arkitekti Skënder Këpuska, është një nga objektet në frymën e vendit që përshkruhet si regjionalizëm kosovar. Kjo ndërtesë i takon arkitekturës moderne - funksionalizmit, është tipike funksionale dhe fleksibile që mund të akomodojnë të gjitha llojet e aktiviteteve dhe ngjarjeve kulturore në qytet, si koncerte, teatër, konferenca, kinema e biblioteka. Shtëpia e Kulturës reflekton arkitekturën moderne të viteve 60-70, me frymëzim nga arkitektura funksionaliste e Alvar Alto, e bazuar në përmasën humane. E vendosur në qendër të qytetit, fasadat e ndërtesës janë të harmonizuara dhe përjetohen në mënyrë të njëjtë në të gjitha anët, ndërsa vëllimet, përdorim i materialeve dhe ngjyrat i janë adaptuar në tërësi shkallës dhe kontekstit urban. Për sa i përket hapësirës publike tejet të gjallë pranë ndërtesës, duhet theksuar lidhja e Shtëpisë së Kulturës me Parkun e Qytetit, me të cilin ndërtesa ndërvepron në mënyrë të përsosur (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.84).

PALLATI I SPORTEVE "SHANI NUSHI"

Pallati i Sporteve "Shani Nushi" është një qendër sportive multi-funksionale në Gjakovë, e cila ndër vite ka qenë shtëpia e shumë klubeve të ndryshme sportive të qytetit. Ndonëse një objekt shumë i rëndësishëm për trashëgiminë moderne në Kosovë, Pallati i Sporteve ka pësuar ndryshime të mëdha në fasadë për shkak të renovimit të vitit 2012 (Wikipedia, 2020). Këto ndryshime janë përcjellë edhe në hapësirën publike përreth ndërtesës, e cila është e pasur me shumë gjelbërim dhe ofron një hapësirë të qetë dhe intime, për dallim nga zhurma që vjen nga rruga "Tirana" që e tangjenton hapësirën në anën perëndimore të ndërtesës.






PEJA

42°39'37"N 20°17'30"E

SHTËPIA E MALLËRAVE



Shtëpia e Mallërave në Pejë është ndërtuar në vitin 1978 nga Svetislav Živković, e vendosur në një kontekst urban dhe e ndërtuar në frymën e vendit. Projekti original i Shtëpisë së Mallërave karakterizohet me një përshtatshmëri me kontekstin përreth, me volume, formë dhe materiale karakteristike të periudhës moderne (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.36). E kufizuar me hapësira për parkim të automjeteve në anën veriore dhe jugore të saj, hapësira publike e ndërtesës konsiston në hapësirën e jashtme të përdhësës së Shtëpisë së Mallërave, përgjatë anës jugore të ndërtesës, e cila e lidhur me shitoret tjera të dy rrugëve që e tangjentojnë objektin, sjell një numër të madh të vizitorëve dhe shfrytëzuesve në këtë pjesë të qytetit.




Fig. 6. Teatri Profesionalist "Istref Begolli" në Pejë (web)

TEATRI PROFESIONIST I QYTETIT "ISTREF BEGOLLI"

Teatri Profesionist "Istref Begolli" është një qendër e artistëve profesionistë të Pejës, i cili vepron për më tepër se 60 vite në Pejë. Nga ky teatër kanë dalë shumë artistë të Kosovës të cilët më pas kanë kontribuar në edukimin e gjeneratave të reja. Teatri poashtu është dalluar për paraqitjet jashtë vendit, gjegjësisht pjesëmarrjet nëpër aktivitete dhe festivale të ish-Jugosllavisë. Vendimi i Këshillit Popullor të qytetit mbi krijimin e Teatrit Amator u lëshua më 27 dhjetor 1950, viti i ndërtimit të objektit nuk dihet saktë, ndërsa arkitektët mendohet të jenë Milan Taic dhe Qemajl Beqiri (informacioni i mbledhur nga biseda me banorët e Pejës).

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, për një periudhë rreth katërvjeçare, Teatri i Pejës është shfrytëzuar për


nevojat e forcave të NATO-s, të cilat ishin stacionuar në rajonin e Pejës. Pas lirimit nga NATO, teatri qëndroi i mbyllur, nga mungesa e interesimit për ta riaktivizuar. Pas disa renovimeve të mëvonshme, rihapja solemne e tij u bë më 26 prill 2003, ndërsa në vitin 2007, pas një angazhimi që teatri të bëhet teatër profesional, u vendos që ky institucion të emërtohet Teatri Profesionist i Qytetit "Istref Begolli" (Berisha, 2010).

Për më tepër, ndërtesa e Teatrit gëzon edhe kualitete shumë të mira të hapësirës publike në anën veriore dhe lindore të saj. Pozita e ndërtesës pranë Lumbardhit të Pejës në veri dhe "Parku i Paqes" në lindje, mundëson krijimin e një hapësire publike të qetë, të pastër dhe relaksuese, me një potencial shumë të madh të shfrytëzimit dhe zhvillimit në të ardhmen.




Fig. 7. Bankkos-i në Pejë (web)


BANKKOS



I projektuar nga arkitektët Qemajl Beqiri dhe Milan Taic rreth vitit 1970, për ndërtesën e Bankkosit nuk ka asnjë formë të dokumentimit, ndërsa projekti i objektit nuk posedohet nga ndokush. Fillimisht ndërtesa ka shërbyer si seli e Bankës Qendrore të Kosovës, në kohën e ish-Jugosllavisë si objekt administrativ me zyre private, ndërsa pas luftës është shfrytëzuar deri me vendosjen e Unmik-ut. Pas Unmik-ut, një pjesë e objektit është shfrytëzuar nga banka NLB, ndërsa sot objekti është i braktisur. Për momentin, ndërtesa është nën pronësinë e AKP-së dhe nuk është i mbrojtur si objekt i trashëgimisë arkitekturale (informacioni i mbledhur nga biseda me banorët e Pejës). Pavarësisht faktit që ndërtesa nuk shfrytëzohet sot, hapja e "Prince Coffee House" në përdheshën e objektit dhe lidhja direkte me sheshin kryesor të qytetit, i jep gjallëri hapësirës publike të anën lindore të Bankkos-it dhe e bën atë të shfrytëzueshme nga të gjithë qytetarët e Pejës.



FERIZAJ
42°22'0"N 21°10'0"E




PALLATI I SPORTEVE "BILL CLINTON"

Pallati i sporteve "Bill Clinton" është ndërtuar në vitin 1982 me arkitekt Miroslav Čočanović, në hyrje të qytetit në magjistralen Ferizaj - Prizren. I ndërtuar nga betoni i armuar, tullat e argjilës dhe qelqi, është ndër të paktët objekte që ka ruajtur arkitekturën origjinale deri më sot. Sistemi konstruktiv kapriatë i kulmit është pjesë përbërëse e artikulimit të dukjeve të ndërtesës, meqenëse këto forma përcillen edhe në fasadë, duke krijuar kështu një lojë dritë-hije. Elementet e theksuara të brutalizmit në fasadë dhe në detaje dekorative i ndihmojnë ndërtesës që të fitojë një monumentalitet të dukshëm në kontekst urban (Elezi & Sadiki, 2017, fq.5).

Kjo ndërtesë është e rrethuar me një hapësirë të madhe publike të gjelbërt, e cila pas intervenimeve të bëra viteve të fundit, është plotësuar akoma më shumë me ndërtimin e fushave të tenisit dhe pingpongut në ambientin e jashtëm. Pavarësisht lokacionit të ndërtesës, përgjatë magjistrales, kualiteti i fushave të jashtme sportive i ka shtuar atraktivitetet hapësirës dhe e ka bërë atë më ftuese jo vetëm për sportistët por edhe për shumë shfrytëzues tjerë të rinj të qytetit.

NDËRTESA ADMINISTRATIVE E KOMUNËS




Ndërtesa e Komunës, e ndërtuar në vitin 1963, me lokacionin e saj afër hekurudhës, e kufizuar me sheshin "Adem Jashari" në perëndim dhe ndërtesat e ngritura më vonë në anën lindore, formësojnë qendrën e qytetit të Ferizajt. E vendosur përballë Hotel "Lybeteni", edhe Ndërtesa e Komunës gëzon të njëjtat kualitete të një hapësire publike shumë vibrante në qendër të qytetit. Sot, kjo ndërtesë ka pësuar shumë ndryshime, duke e bërë të vështirë dallimin e ndërtesës origjinale, e cila ka qenë tipike e fazës së parë të arkitekturës moderne. Me dritare horizontale e gjeometri të rregullt, komuna jepte përshtypjen e një ndërtese të thjeshtë, në krahasim me objektet tjera administrative të kohës të cilat karakterizoheshin me përdorim të ornamenteve dhe monumentalitet të theksuar. Në ndërtesë dalloheshin qartë pesë pikat e Le Corbusier, duke prezentuar dukshëm të arriturat kulminante të periudhës moderne në arkitekturë (Elezi & Sadiki, 2017, fq.67).

HOTEL "LYBETENI"

Hotel "Lybeteni" është ndërtuar në vitin 1960, nga arkitektët D. Šugarčev, I. Šabić dhe M. Damjanović. Është i përbërë prej përdhësës dhe tre etazhave të tjera, ndërsa struktura e hotelit është e formuar nga elemente modulare që përsëriten dhe shfaqen edhe në fasadë, duke reprezentuar kështu zona me funksione specifike. Elementet karakteristike për këtë ndërtesë janë muret e tërhequra të përdhësës dhe brisoletë, të cilat përveç funksionit mbrojtës nga dielli, krijojnë edhe dinamikë në fasadën e objektit përmes lojës së dritës dhe hijes. Pozita në qendër të qytetit dhe figura e kamarierit që mban tabakën, gjegjësisht murali në fasadën balllore të hotelit, e bëjnë këtë objekt identifikues të qytetit të Ferizajt (Elezi & Sadiki, 2017, fq.39).

Meqenëse Hoteli është i bllokuar me ndërtesa tjera në drejtimin veri-lindor dhe veri-perëndimor, hapësira publike pranë tij konsiderohet bulevardi dhe sheshi "Adem Jashari" në lindje. Sheshi ka pësuar ndryshime dhe ndërrhyrje të shumta ndër vite, e së fundmi i është shtuar edhe nënkalimi që lidh pjesën jugore të qytetit me atë veriore. Megjithatë, ajo që nuk ka ndryshuar është fluksi i madh i mobilitetit dhe shfrytëzuesve të hapësirës, të cilët i japin një gjallëri të pareshtur qendrës së qytetit.








Fig. 8. Motive nga Ferizaj, Posta e qytetit
(Elezi & Sadiki, 2017)



NDËRTESA E POSTËS


Ndërtesa e Postës është ndërtuar në vitin 1977, nga arkitekti M.Višnjić, në periudhën e përfundimit të fazës së parë të modernizmit në Ferizaj dhe paraqitjen e elementeve të fazës së dytë. Si ndërtim karakterizohet me një ekspresionizëm të theksuar dhe elemente të fuqishme të konstruksionit, ku shprehja gjeometrike dhe konstruktive, si dhe loja ekspresive e volveve të ndërtesës prezantojnë një dozë jashtëzakonisht të dukshme të monumtialitetit (Elezi & Sadiki, 2017, fq.17).

Me pozitën e saj dhe elementet arkitektonike, Posta është akomoduar në një mjedis me ndërtime të modernes, përderisa perdhesa e lirë rrit vetëbesimin dhe dominimin e ndërtesës në bulevardin kryesor të qytetit. Në këtë rast, hapësira publike e ndërtesës konsiston në përdhësën e lirë të saj dhe hapësirën e gjelbërimit në anën jugore të objektit. E lidhur në mënyrë direkte me bulevardin në jug, parkun e ri të qytetit në veri dhe hapësirën publike të Bibliotekës "Sadik Tafarshiku" në perëndim, edhe hapësira publike e Ndërtesës së Postës gjallërohet dhe shfrytëzohet nga fluksi i madh i njerëzve që e karakterizon këtë pjesë të qytetit.




STACIONI POLICOR

Ndërtesa e stacionit policor është ndërtuar në vitin 1976, me monumentalitetin që tregon qartë funksionin e objektit që në pamjen e jashtme të tij. Elementet e hapjeve, brisoletë, ngjyra e bardhë dhe loja dritë-hije tregojnë një pastërti, ritëm, harmoni të theksuar në detaje dhe dinamizëm në fasadë, karakteristika kryesore këto të fazës së parë të arkitekturës moderne në Ferizaj. Shtesa në objekt i shton akoma më shumë monumentalitetit të tij, duke paraqitur kështu në të njëjtën kohë aspirata të fazës së dytë të modernizmit, e cila paraqitet me vonesë në Kosovë (Elezi & Sadiki, 2017, fq.15). Duke marrë parasysh funksionin e ndërtesës dhe faktin që hapësira publike pranë saj është e rrethuar me gardh, kjo hapësirë është vetëm në shërbim të punonjësve të ndërtesës dhe nuk është e qasshme nga qytetarët e tjerë.




BANKKOS - PJESA ADMINISTRATIVE

E projektuar në vitin 1979 nga arkitektët M. Višnjić dhe S. Odović, ndërtesa ka shërbyer si ndërtesë administrative, gjegjësisht bankë, përderisa sot është shndërruar në kolegji. Përdhesa është e tërhequr brenda, fasada është e veshur me pllaka, ndërsa të gjitha elementet e ndërtesës janë në formë drejtëkëndore. Pavarësisht lokacionit të mirë, përballë hotelit "Lybeteni", në hyrje të bulevardit të qytetit, ndërtimet e larta të mëvonshme në afërsi kanë ndikuar që ndërtesa të humb vëmendjen e saj dhe në krahasim me ndërtesat tjera moderne në Ferizaj, të jetë pothuajse e padukshme (Elezi & Sadiki, 2017, fq.31). Si pasojë, hapësira publike pranë ndërtesës në jug, për dallim nga gjallëria që e karakterizon hapësirën në anën veriore përgjatë bulevardit të qytetit, është mjaft e varfër dhe përbëhet nga pjesa që shfrytëzohet për parkim të automjeteve dhe disa kafeteri.




GJILAN

42°27'53"N 21°28'1"E




HAPËSIRAT PUBLIKE MODERNE NË GJILAN

Në komunën e Gjilanit, në këtë hulumtim janë identifikuar dy ndërtesa të rëndësishme të ndërtuara në vitin 1976, nga arkitekti Miodrag Pecić, Shtëpia e Mallërave dhe Rrokaqielli apo kulla e banimit në Gjilan, të cilat janë ndërtesa shumë të veçanta, që dallohen për nga format e thjeshta dhe volumet modeste. Kulla e banimit, për më tepër, trajton temën e përputhjes së dy shkallëve të ndryshme dhe përshtatjes në kontekstin urban (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.34-35).



ISTOG

42°47'0"N 20°29'0"E



MOTEL "TROFTA"

Komuna e Istogut është pjesë e këtij hulumtimi poashtu, me Motelin "Trofta", i cili me pavijonët e tij është një prej projekteve më interesante të periudhës moderne në Kosovë. Ky kompleks i ndërtuar në vitin 1979-80, nga arkitekti Qemail Beqiri, ka një siluetë që përsërit format e maleve përreth dhe është një simbiozë e disa funksioneve të lidhura me ujin si resurs natyror, që shrytëzohet si në aspektin ekonomik e edhe në atë mjedisor dhe rekreativ. Projekti karakterizohet me detajet tipike të kustruksionit të drurit të cilat me shumë kujdes janë bartur në konstruksionet betonarme (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.36-37). Arkitektura origjinale e restorantit dhe bungalove është e komponuar jashtëzakonisht mirë në mjedisin natyror, përreth ujit dhe me pamje nga bjeshkët e Istogut. Megjithatë, pas privatizimit, restoranti i motelit ka pësuar ndryshime të mëdha nga arkitektura origjinale në interior dhe eksterier, ku pavarësisht zgjerimit të përmbajtjeve të restorantit, kualitetet mjedisore të dikurshme kanë humbur (Gjinolli & Kabashi, 2015, fq.92).

HAPËSIRAT PUBLIKE ME POTENCIAL PËR INTERVENIM

Hulumtimi i literaturës ekzistuese mbi hapësirat publike moderne në Kosovë, i përmbledhur në kapitullin paraprak, është pasuar nga vizitat në terren në qytetin e Prishtinës, Pejës dhe Ferizajt. Nga një listë e gjatë hapësirash publike me potencial për intervenim, duke u bazuar në gjetjet nga vizitat në lokacion, kufizimin/lejimin e shfrytëzimit të hapësirave varësisht nga funksioni i ndërtesës të cilën e rrethojnë, apo mundësitë për ndërhyrje, lista është reduktuar në një numër të caktuar të hapësirave publike të cilat kanë potencial për intervenim.

Rrjedhimisht, ky kapitull do të listojë disa hapësira publike moderne në qytetet e lartpërmendura, duke analizuar gjendjen ekzistuese të secilës hapësirë, përparësitë e tyre, mangësitë dhe problemet që i shoqërojnë ato. Me qëllim parandalimin e keqtrajtimit dhe shkatërrimit të mëtejshëm të tyre, janë propozuar disa ide të ndryshme të ndërhyrjeve urbane në hapësirë, gjithmonë duke synuar krijimin e hapësirave kualitative të cilat ofrojnë mundësi për t'u shfrytëzuar nga të gjitha grupet e shoqërisë dhe ngrisin vlerat e trashëgimisë moderne në qytetet tona.

Në Prishtinë janë propozuar intervenime në hapësirat publike rreth Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Ndërtesës së Institutit Albanologjik, Monumentit "Vllaznim-Bashkim", Komplexit të Kurrizit, Trekëndëshit të Dardanisë, Qendrës tregtare "Bregu i Diellit", Ndërtesës së banimit në Bregun e Diellit, Pallatit të Shtypit "Rilindja", Ndërtesës së Postës, Mensës, Galerisë Kombëtare të Kosovës dhe Pallatit të Rinisë. Në Pejë, në hapësirat rreth Ndërtesës së Bankkos-it dhe Shtëpisë së Mallërave, përderisa në Ferizaj në ato pranë Pallatit të Sporteve "Bill Clinton" dhe Bankkos-it.



Fig. 9&10. Gjendja ekzistuese e hapësirës publike pranë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës (nga autorët)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës:

Biblioteka Kombëtare e Kosovës paraqet pikën fokale të Kampusit Universitar. Si e tillë, ajo pret dhe akomodon më shumë se 45,000 studentë dhe qytetarë të tjerë të cilët jodomsdoshmërisht e shfrytëzojnë këtë hapësirë për aspekte universitare. Pozita e mirë dhe sipërfaqja e mjaftueshme janë potencialet kryesore për një zhvillim të mundshëm. Megjithatë, hapësira publike përreth BKK-së ka probleme serioze dhe bazike si nga mungesa e aktiviteteve, atyre infrastrukturore dhe teknike.

Pavarësisht faktit që trupat ndriçues ekzistojnë, ato janë jo-funksionale me ndalesa të papritura të ndriçimit. Po aq crucial është problemi i qasjes së personave me mundësi të kufizuara i cili disa vite me rradhë është kërkuar të zgjidhet. Një përpjekje e tillë është bërë në hyrjen jugore të kësaj hapësire, përkatësisht në pjesën perëndimore të objektit Radio "Prishtina", megjithatë ekziston një shpërfillje e rregullave elementare për zgjidhjen e mobilitetit për këtë grup shoqëror. Hapësira publike përreth BKK-së është e kapluar edhe nga probleme tjera si mungesa e mobiliarit urban, sinjalistikës, lëvizjes së pakontrolluar të qenve endacakë, kryesisht të natyrës menaxhuese institucionale (Fig.9&10). Megjithatë, kohëve të fundit është parë një përkujdesje më e shtuar sa i përket mirëmbajtjes së pastërtisë, vendosjes së pavilioneve të vogla si rigjeneratorë urbanë apo mbjelljes së fidaneve të reja nga disa banka private apo federata sportive.

Një hapësirë me potencial si kjo e BKK-së mund të përqafojë intervenime dhe ide të natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato që plotësojnë nevojat bazike të qytetarëve, siç janë: qasja, mobiliteti, sinjalistika, zgjidhja për strehimin e qenve endacakë, vendosja e mobiliarit urban e ndriçimit dhe mirëmbajtja. Megjithatë, përveç transformimeve të prekshme, kjo hapësirë është e përshtatshme edhe për ndërhyrje jetëshkurta dhe kalimtare siç janë pavilionet, skulpturat urbane dhe ekspozitat, në mënyrë që të nxiten marrëdhënie të reja mes individëve brenda komunitetit, si dhe të krijohet lidhja e qytetarëve me njëri-tjetrin dhe me qytetin e tyre.



Fig. 11. Gjendja ekzistuese e përdhësës së lirë të Institutit Albanologjik (nga autorët)

Ndërtesa e Institutit Albanologjik:

Shkëlqimi historik por edhe sakrificat që janë bërë në të kaluarën nuk mjaftojnë për të mbijetuar, pasi jeta dhe aktualiteti ekzistues kërkojnë përshatje ndaj kushteve të reja. Sot, hapësira publike përreth kësaj ndërtese, pavarësisht që komplementon kampusin universitar, është në gjendje jo të mirë. Mungesa e funksioneve përcjellëse jashtë mureve të ndërtesës dallohet qartë sepse gjallëria e cila supozohet të mbështjellë objektin, është dukshëm e mohuar.

Në aspektin e shtrirjes urbane, ndërtesa ndjek lehtësisht topografinë e terrenit dhe vendosja e saj në lokacion i ka mundësuar një sipërfaqe të kënaqshme për qark objektit. Megjithatë, në relacion me ndërtesat përreth, kjo hapësirë zbehet dhe humbet rëndësinë e saj. Fushat e sportit në pjesën veriore të objektit, si funksione shtesë të Fakultetit të Shkencave Sportive dhe vendparkingjet për të dy këto institucione e kanë shpërfillur mundësinë e një lidhjeje më të pranueshme me kampusin universitar.

Mungesa e mobiliarit urban ka zbrapsur aftësinë ftuese të hapësirës ndaj punëtorëve të institutit, lëre më qytatarin kalimtar. Edhe pse dallojmë një paternë të shthurur, të lirë e të parregulluar të gjelbërimit, ai mbetet një nga elementet e vetme pozitive të kësaj hapësire që rrethon objektin, sidomos në fasadën ballore nga ana e rrugës (Fig.12).

Duke u bazuar në gjetjet nga vizita në terren, konsiderojmë se një nga intervenimet më të nevojshme në këtë hapësirë është largimi i automjeteve të cilat i gjen kudo përreth ndërtesës, në mënyrë që të bëhet një lidhje më e mirë e hapësirave publike të kampusit në tërësi, dhe qasje më e mirë për studentët dhe kalimtarët. Përdhësës së lirë të ndërtesës mund t'i shtohet atraktiviteti përmes intervenimeve në formë të ekspozitave dhe skulpturave urbane, përderisa theksimi i disa shtigjeve dhe një mobiliar urban fleksibil do të kthenin vëmendjen nga gjelbërimi dhe do të mundësonin një shfrytëzim të hapësirës nga të gjitha grupmoshat.



Fig. 12. Gjelbërimi ekzistues në hapësirën publike të Institutit Albanologjik (nga autorët)

Monumenti "Vllaznim-Bashkim":

Monumenti revolucionar i ashtuquajtur "tre-rremëshi" apo "trekëndëshi" gëzon një pozitë të privilegjuar në kryeqytetin e Kosovës për pesëdhjetë vitet e fundit. Edhe pse në mesin e banorëve vendas e gjithë hapësira përgjithësisht e mban emrin "Vllaznim-Bashkimi", në të vërtetë ajo gjendet në atë që tani quhet sheshi "Adem Jashari". Paradoksale apo jo, ky është një realitet kryeqytetas, veçanërisht nëse e shohim këtë monument jashtë kontekstit origjinal. Megjithatë, monumenti është i rëndësishëm për vlerat artistike, si dhe referim ndaj një periudhe të caktuar historike të zhvilluar edhe në trevat kosovare.

Monumenti qendror dhe sheshi rreth tij, si shumë ndërtesa të epokës jugosllave në Kosovë, nuk ka status të mbrojtur të trashëgimisë kulturore. Veç kësaj, për shkak të afërsisë me Qendrën Historike të Prishtinës, kufijtë e së cilës janë vetëm disa metra larg, kjo zonë është formalisht e konceptuar si një "zonë ndarëse". Si e tillë, në vitin 2018, kjo hapësirë është riprojektuar dhe rezultat i dizajnit është rritja e sipërfaqes së gjelbërt, të integruar me një dysheme urbane të re (Prishtina Online, 2018). E tërë pamja dhe hapësira në të vërtetë janë imazh ikonik i qytetit,



Fig. 13. Gjendja ekzistuese e sheshit "Adem Jashari" (nga autorët)

vendtakim për të rinjtë dhe vend ku mund të kalojnë kohën grupe të shumëllojshme të njerëzve (Fig.13).

Hapësira kryesisht akomodon qytetarë në moshë të shtyer, dhe me rrallë rininë e veçanërisht fëmijët, si pasojë e largimit të skate-parkut që gjendej në njërin krah. Rrjedhimisht, një ide për intervenim do të ishte në dyshemenë urbane, ku përmes ngjyrave dhe vizatimeve të lojërave për fëmijë, hapësira do të bëhej më ftuese dhe atraktive edhe për fëmijët. Hapësira publike në përgjithësi është mjaft kualitative dhe është e pajisur me mobiluar urban të ri e të mjaftueshëm. Megjithatë, një korrigjim në aspektin e orientimit të tyre do të ishte i mirëseardhur.

Trekëndëshi i Dardanisë:

Hapësira urbane "Dardania" ka një formë trekëndëshi e përkufizuar me rrugë mjaft të frekuentuara. Përparësitë e kësaj hapësire publike që duhen theksuar janë sipërfaqet e konsiderueshme të lira dhe të gjelbërta, si dhe konfiguracioni i terrenit i cili ka lejuar që në periudhën e kaluar kohore, për këtë lagje të hartohen disa projekte, me qëllim të ngritjes së nivelit të banimit, punës, rekreimit dhe jetës së përditshme në përgjithësi. Edhe pse shumë nga ato ide kanë mbetur vetëm në letër, dallohet një investim kryesisht në mirëmbajtjen e hapësirës.

Nga vizitat e fundit në terren është parë ndërtimi i një parku të ri të lojërave për fëmijë i cili dukshëm ka gjallëruar vendin, së bashku me fushën e basketbollit dhe parkun me emrin e heroit "Triumf Riza". Në përdhësën e objektit, në anën e kafeneve dhe funksioneve të tjera afariste problem akoma mbetet zhurma dhe ndriçimi i pamjaftueshëm, sidomos gjatë kalimeve tek pasazhet e objektit. Pavarësisht kësaj, ajo rrugë mbetet akoma shumë e frekuentuar dhe paraqet një nga hapësirat më të rëndësishme rinore në mbamendjen kolektive të kryeqytetit.

Numri i vendparkingjeve mbetet akoma problem serioz për shkak të hapësirës së konsiderueshme të cilën e uzurpojnë, e cila lirshëm mund të shfrytëzohet për aktivitete të përditshme në dobi të banorëve (Fig.14). Në këtë rast, intervenimet duhet të përqëndrohen në pasazhet e ndërtesave të banimit, ku përmes ndriçimit të mirë, mirëmbajtjes dhe intervenimeve në dyshemenë urbane apo muret e pasazheve, mund të ofrohet siguri për banorët dhe kalimtarët si dhe të bëhet theksimi i hyrjeve në ndërtesë dhe në hapësirën publike.



Fig. 14. Gjendja ekzistuese e hapësirës publike të Trekëndëshit të Dardanisë (nga autorët)



Fig. 15&16. Gjendja ekzistuese e hapësirës publike të Kompleksit të Kurrizit (nga autorët)

Kompleksi i Kurrizit:

Kompleksi biznesor-rezidencial "Kur-rizi", apo "zonja e vjetër" e Prishtinës, prej shumë vitesh ka shërbyer si një kështjellë stabiliteti në hyrje të kryeqytetit. Përdhesa e këtij kompleksi pasqyron gjallërinë që zë vend mes dyqaneve tregtare dhe këmbëve të banorëve që "vërshojnë" çdo ditë këtë hapësirë. Element i veçantë mbetet tuneli i automjeteve, i cili i ngjan një labirinti të zyrtë në të cilin banojnë mijëra banorë. Mbi të, blloqet banesore shtrihen në mënyrë progresive, gjë që së bashku me vendndodhjen e përgjithshme të strukturës, i shton energji të gjithë kompleksit. Bulevardi pothuajse 400 metra i gjatë që shtrihet mbi tunel i ngjan një pasarele për grupmoshat e ndryshme që jetojnë rutinën e tyre në këtë pjesë të qytetit (Fig.15&16).

Dyqanet e kafenetë e vogla mund t'i ketë ndryshuar efekti i globalizmit, por tradita ka mbetur e paprekur. Megjithatë, me gjithë rezistencën që i ka bërë kohës, Kurrizi nuk është i njejt

që ka qenë. Në këtë rast po flasim për ndryshime pozitive të cilat janë ndërmarrë viteve të fundit, ku përmendim rimodelimin e dyshemesë së pllato së, shtimin e funksioneve dhe aktiviteteve që grumbullojnë mosha të ndryshme të shoqërisë, qasjen e duhur ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe gjelbërimin deri diku të mjaftueshëm.

Si rrjedhojë, intervenimet urbane potenciale në këtë hapësirë duhet të adresojnë problemet me ndriçimin, aspektin e zhurmës, ventilimin dhe largimin e erërave të pakëndshme që vijnë nga tuneli, si dhe problemin e vendparkingjeve i cili mbetet akoma i pazgjidhur nga autoritetet komunale. Për më tepër, një hapësirë me shumë potencial është amfiteatri i ri i cili mund të shërbejë për organizimin e aktiviteteve të ndryshme edukative, për debate publike apo edhe për shfaqjen e filmave dhe dokumentarëve, duke ju dhënë kështu shkas banorëve që ta shfrytëzojnë dhe të kalojnë akoma më shumë kohë në Kompleks.



Fig. 17. Hapësira publike e ndërtesës së banimit në lagjen "Bregu i Diellit" (nga autorët)

Ndërtesë banimi, Bregu i Diellit:

Ndonëse shkallët tek objektet e banimit në Bregun e Diellit arrijnë të ngjallin një ndjenjë surrealistike për banorët, nuk mund të thuhet se vlen e njëjta gjë edhe për hapësirat jashtë mureve të ndërtesës. Shihet një mungesë e dukshme investimi në çdo aspekt, me probleme esenciale si ndriçimi, sinjalistika, pastërtia apo mundësia për shfrytëzimin e hapësirës (Fig.17).

Shtigjet e rrugëve janë të pllakosura, mirëpo, mirëmbajtja e tyre nuk është në nivelin e duhur. Mungesa e shportave të mbeturinave ka shtuar ndotjen në hapësirë, dhe mungesa e trupave ndriçues ka krijuar një ndjenjë pasigurie për banorët dhe kalimtarët e përditshëm. Nga vizitat për analizimin e gjendjes ekzistuese, rezultoi që hapësira shfrytëzohet kryesisht si

rrugë tranzit për të kaluar nga njëri skaj në tjetrin dhe pamundësia e shfrytëzimit të hapësirës ka bërë që qytetarët të humbasin interesimin për të kaluar kohë në këtë vend.

Nisur nga fakti se njerëzit kanë të drejtën e përdorimit të hapësirës publike dhe të drejtën e qytetit, për sa i përket intervenimeve, vizionimi mbështetet në krijimin e përmbajtjeve të reja bazuar në integrimin social gjithëpërfshirës dhe solidaritetin social. Nëpërmjet intervenimeve në formën e mobiliarit urban dhe në formën e pavilioneve/skulpturave urbane, inskenohet jeta publike dhe lëvizja në hapësirë, duke zbuluar kështu mundësi për të mbështetur diversitetin, bashkimin dhe tjetërsinë në kontekst urban.



Fig. 18&19. Gjendja ekzistuese e hapësirës publike përreth qendrës tregtare "Bregu i Diellit"
(nga autorët)

Qendra tregtare "Bregu i Diellit":

Hapësira publike përreth qendrës tregtare "Bregu i Diellit" është një nga vendet me potencialin më të madh për zhvillim e në të njejtën kohë, një nga hapësirat e lëna pas dore e të pa jetë të periudhës moderne. Përgjatë lëvizjeve që bëjnë për qark këtij objekti kemi parë shumë kënde të "vdekura" të cilat nuk të ngjallin ndjenjën e sigurisë për një shfrytëzim adekuat, ato rrjedhimisht humbin edhe aftësinë për të krijuar një afinitet me hapësirën.

Mobiliari i përzgjedhur urban nuk është aspak ftues dhe krijon përshtypjen e një zone të ftohtë, të zyrtë e aspakt mikpritëse pavarësisht se hapësira gumuzhinë nga numri i madh i nxënësve nga afërsia me shkollën fillore "Ismail Qemali". Qasja për personat me aftësi të kufizuara është e pamundur, komponent ky që i ka përcjellur

këto hapësira që nga ndërtimi i objekteve në atë kohë. Një nga elementet pozitive të kësaj hapësire mund të konsiderohet gjelbërimi i mjaftueshëm dhe mirëmbajtja sa i përket pastërtisë (Fig.18&19).

Rjedhimisht, kjo hapësirë ka nevojë për intervenime në mobiliar urban, me qëllim që t'u ofrojë banorëve dhe kalimtarëve të drejtën e spontanitetit dhe befasisë, momente të komunikimit dhe konfliktit, shkëmbim të kulturave dhe ideve, e shumë përvoja të tjera, duke rikthyer kështu lidhjen e banorëve me vendin e tyre. Pjesëmarrja dhe plotësimi i nevojave të komunitetit është poashtu shumë e rëndësishme, me qëllim që procesi i projektit të shndërrohet në çështje kolektive dhe të arrihet dialog ndërmjet të gjitha palëve të përfshira.

Ndërtesa e Postës:

Rëndësia e Postës së Kosovës që nga vitet e 80-ta e deri më sot ka qenë substanciale për zhvillimin e vendit në të gjitha format, qoftë në shpërndarjen e rrjetit të telekomunikacionit e deri te estetika e siluetës së kryeqytetit. Të njëjtën rëndësi ka gëzuar edhe hapësira publike rreth saj, por e cila u zbeh me kalimin e kohës. Ndër vite ajo ka pësuar dëme të konsiderueshme, nisur që nga dyshemeja urbane e deri te vandalizmat në sipërfaqet përreth. Përmes vizitave në terren kemi arritur të shohim një përmirësim të dukshëm sa i përket mirëmbajtjes, veçanërisht me ndërtimin e parkut të ri në pjesën perëndimore të saj i cili i plotëson të gjitha

nevojat e qytetarit (Fig.20). Vizionimi i kësaj hapësire publike qëndron në adresimin e problemit të vetëm të cilin e kemi konsideruar në hapësirën përreth Postës, e që është sanimi i shkallëve dhe krijimi i mundësisë për lëvizjen e personave më aftësi të kufizuara. Shkallët e Postës karakterizohen me një monumentalitet dhe prezencë të theksuar në lokacion, duke qenë kështu të përshtatshme për instalimin e ekspozitave të ndryshme apo eksperimenteve të hapura në hapësirë, për të transformuar kështu shkallët në një skenë dhe për të përplasur kalimtarët me mister dhe me një moment të papritur befasie në rutinën e tyre të përditshme (Fig.21).



Fig. 20. Hapësira publike pranë Ndërtesës së Postës (nga autorët)



Fig. 21. Gjendja ekzistuese e shkallëve të Postës (nga autorët)

Galeria Kombëtare e Kosovës:

Grumbulluese e shumë veprave artistike dhe mikpritëse e shumë ekspozitave kombëtare e ndërkombëtare, realiteti jashtë mureve të kësaj ndërtese nuk është aq ekspresiv. Objekti është institucioni i radhës i cili zë një pjesë të sipërfaqes së kampusit universitar, pozicionuar menjëherë në pjesën prapa Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, përkatësisht në anën lindore të saj.

Në aspektin e mirëmbajtjes hapësira gëzon një përkujdesje të kënaqshme, mirëpo çalon në përmbajtjen e aktiviteteve të ndryshme që do t'i ngrisin vlerën akoma më shumë. Është e rrethu-

ar me gjelbërim të ulët dhe në disa pjesë të lartë i cili gjithashtu është në gjendje të mirë. Dallohet një mungesë e inventarit urban i cili do të mund të shfrytëzohej si për pritje para Galerisë apo edhe për pushim nga kalimtarët e rastit (Fig.22). Element shqetësues mund të konsiderohet edhe numri i parkingjeve përballë hyrjes kryesore që në një formë apo tjetër i jep një efekt jo atraktiv këtij institucioni të lartë artistik.

Kështu, vizionimet potenciale për këtë hapësirë mund të konsiderohen zhvendosja e vendparkingjeve në parkingun e ri nëntokësor në hyrje të kampusit universitar me qëllim të lirim të sipërfaqes. Kjo do të mundësonte shtimin e funksioneve të reja në dobi të Galerisë si është mundësia e ekspozimit në ambiente të jashtme. Kjo mund të realizohej në formën e një mobiliari urban i cili gjithashtu mund të plotësonte nevojën tjetër të kësaj hapësire.



Fig. 22. Hapësira publike pranë Galerisë Kombëtare të Kosovës (nga autorët)



Fig. 23&24. Gjendja ekzistuese e hapësirës publike të Pallatit të Shtypit "Rilindja"
(nga autorët)

Pallati i Shtypit "Rilindja":

Pas transformimeve në vendin dhe kohën ku jetojmë të njohura si "renovime", Pallati i Shtypit "Rilindja", e shumë objekte të tjera, lavdia dhe simbolika e të cilave ka përcaktuar me kohën, i njëjti fat duket se po i ndjek edhe hapësirat publike të ndërtuara bashkë me to. Mbi 6400 m² vetëm nga ana e fasadës ballore, përkatësisht nga rruga "Kosta Novakoviç" e bën këtë hapësirë adekuate për një shkëputje nga realiteti dinamik i jetës në kryeqytet.

Megjithatë, kjo hapësirë është rrethuar me një gjelbërim të shturrur dhe grila nga të gjitha anët, që për shumicën e qytetarëve nuk e bën aspak ftuese, shtu këtu faktin që ka qasje vetëm nga njëra anë, hyrje e cila gjithashtu nuk është e dallueshme. Nga brenda, hapësira është e pasur me gjelbërim të bollshëm, si ai i lartë apo i ulët, i cili ka minimizuar zhurmën që vjen nga fluksi i lëvizjes në qytet. Hapësira nuk është e mirëmbajtur në aspektin e pastërtisë dhe dallohet një abuzim i dyshemesë nga ndotja me mbeturina, ndërsa mobiliari

urban plotëson nevojat e shfrytëzuesve edhe pse në gjendje jo dhe aq të mirë.

Klimaksi i sekuençave të lëvizjes kufizohet përmes rrathëve koncentrik duke përfunduar në një lapidar të dëshmorit të kombit. Pamundësia për të shfrytëzuar hapësirën ka ndikuar që qytetarët të humbasin interesimin për të kaluar kohë në këtë vend. "Territorializimi" i hapësirës me katër Ministri të shtetit, sikur ka institucionalizuar hapësirën dhe ka larguar shfrytëzuesin potencial për të kaluar kohë në të. Rrjedhimisht, fokusimi në aspektin e transformimit të hapësirës publike duhet parë përmes subjektiviteteve të ndryshme të mobilitetit, duke bërë rezistencë ndaj dinamikave të vendosura të pushtetit që lejojnë/kufizojnë lëvizshmëri të ndryshme në një hapësirë me kaq shumë potencial në qytet. Poashtu duhet intervenuar edhe në kualitetin e dyshemesë urbane dhe mobiliarit urban, me qëllim krijimin e një hapësire ideale për arratisje dhe qetësi nga kaosi metropolitani.

Mensa e Studentëve:



Fig. 25. Gjelbërimi ekzistues në hapësirën publike të Mensës së Studentëve (nga autorët)

Mensa e Studentëve paraqet një nga mekanizmat kyç në të cilën studentët ushqehen në Universitetin e Prishtinës. Si e tillë, ajo pret një numër të konsiderueshëm të individëve në baza ditore dhe meqenëse fluksi i madh i lëvizjes shpeshherë pamundëson mirëmbajtjen e duhur të një hapësire, kështu edhe Mensa e Studentëve vazhdimisht ka hasur në këtë problem.

Përdhesa e objektit përveç pritjeve të shkurtëra apo kryerjen e funksioneve të shpejta të studentëve nuk shfrytëzohet për ndonjë aktivitet tjetër, megjithëse gëzon një hapësirë të konsiderueshme dhe ofron një pamje të mahnitshme të qytetit. Terreni i pjerret ka kufizuar nga njëra anë të ketë funksione përcjellëse, mirëpo, në anën tjetër, kjo nuk justifikon faktin për

të mos rregulluar hapësirën në aspekt përmbajtësor, qoftë në rregullimin e basamakëve në shkallët e dëmtuara apo në ofrimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara (Fig.26).

Për më tepër, pjesë e vizionimit është edhe hapësira publike e mbuluar, e cila meqenëse është pjesa më e frekuentuar e objektit, mund të përqafojë ndërhyrje urbane të cilat janë të prirura të jenë jetëshkurta dhe kalimtare, siç është rasti i intervenimeve në formën e ekspozitës dhe pavilioneve. Këto ndërhyrje, sado të vogla, kanë një ndikim të madh në shoqërinë dhe qytetin pavarësisht kohëzgjatjes dhe shkallës, dhe mundësojnë që studentët dhe kalimtarët të kalojnë më shumë kohë në hapësirën publike të objektit të Mensës.



Fig. 26. Gjendja ekzistuese e shkallëve të Mensës së Studentëve (nga autorët)



Fig. 27. Gjëlberimi ekzistues në hapësirën publike pranë Pallatit të Rinisë (nga autorët)



Fig. 28. Gjendja ekzistuese e pllatosë së Pallatit të Rinisë (nga autorët)

Pallati i Rinisë (Boro dhe Ramizi):

Një shembull tipik i arkitekturës radikale metaboliste qëndron paradoks me atë që kjo frymë prezenton në raport me hapësirën publike përreth ndërtesës, përkatësisht në platonë e famshme të tij e cila nuk arriti të përfundohej sipas planit të parashikuar nga arkitekti Janković. Kjo hapësirë paraqet gjithashtu një nga zonat me potencialin më të madh për shfrytëzim në kryeqytet pasi njihet nga çdo moshë (Fig.28).

Si e tillë për nga rëndësia, ajo megjithatë ngec në shumë aspekte, disa prej tyre të cilat mendohen të jenë esenciale, si mungesa e mjaftueshme e ndriçimit. Problem tjetër konsiderohen dëmet e pllakosjes në dysheme, vandalizmat në sipërfaqet përçark dhe mungesa e gjelbërimit. Viteve të fundit hapësira është shfrytëzuar për disa aktivitete të ndryshme të organizuara qoftë nga organet komunale apo disa organizata jo-qeveritare, të cilat kanë gjallëruar pamjen e vendit. Kjo nënkupton që hapësira ka nevojë për disa intervenime afatgjate në formën e regjeneratorëve urbanë të cilat do ta mbanin vazhdimisht këtë hapësirë të këndshme për qytetarin që të kalojë kohë në të. Nga disa vizita të herë pas hershme në lokacion, është dalluar një

mirëmbajtje e duhur në aspektin e pastërtisë. Nga njëra anë, hapësira ofron pamje interesante dhe argëtuese në disa pjesë të saj. Në anën tjetër, për shkak të formës dhe vendosjes së objektit, krijohen shumë kënde të vdekura të cilat ngjallin shqetësim për shfrytëzuesit. Një nga problemet që kërkon zgjidhje emergjente mund të konsiderohet krijimi i qasjes për grupet shoqërore me aftësi të kufizuara, të cilët janë abstrahuar nga aksesimi në këtë hapësirë.

Meqenëse kjo hapësirë publike ofron një sipërfaqe të mjaftueshme, vizionimi për platonë e Pallatit të Rinisë dhe Sporteve padyshim që mbështet në shtimin e aktiviteteve të reja për të pasuruar jetën publike. Këto aktivitete mund të vijjnë në formën e krijimit të vendeve për lojë, parqeve të vogla apo "dhomave" urbane siç konsiderohen pavilionet. Përfundimi i projektit të arkitektit Janković, lidhja mes dy platove, asaj të Grandit dhe Pallatit, gjithashtu mund të konsiderohej një ide vizionare, nëse jo e prekshme, padyshim përmes okularëve virtual për të krijuar ndjenjën e plotësisht dhe ri-imagjinimit të atij projekti.




Fig. 29&30. Gjendja ekzistuese e hapësirës publike pranë Bankkos në Pejë (nga autorët)

Bankkos:

Objektet me hapësirat përcjellëse publike të tyre që nuk janë privatizuar akoma, kanë një potencial të madh transformues. Ato ndryshohen lehtësisht në vende dhe objekte që komuniteti mund t'i përdorë për arsye sociale dhe kulturore. I njëjti rast ndjek edhe objektin e famshëm të Bankkosit në Pejë, shembull tipik i arkitekturës brutaliste, hapësira publike e të cilit i takon sheshit qëndror të qytetit (Fig.29&30).

Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një ndërtesë, përdhessa e së cilës shfrytëzohet nga një rrjet i njohur i kafeve në vend, çka do të thotë që e gjithë fasada ballore nga ana e sheshit është e zënë me shërbimet e këtij kontraktori privat. Si e tillë, ajo është dukshëm e rregulluar dhe e mirëmbajtur në të gjitha aspektet teknike. Parkingu në anën lindore të saj mund të paraqesë një potencial për një përdorim më inovativ sepse nga analiza e gjendjes ekzistuese nuk përkon aspak me rrethinën.

Vizionimi i hapësirës publike të Bankkosit në Pejë mund të konsistojë në dy komponenta kryesore, asaj të largimit të vendparkingjeve ose zvogëlimit të numrit të tyre dhe shtimi i inventarit urban. E para, padyshim që do të lironte hapësirën për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme dhe do të mundësonte shtimin e gjelbërimit i cili është i pakët në atë zonë, ndërsa e dyta, do të krijonte ndjenjën e përkatësisë për hapësirën sepse qytetarët do të kalonin më shumë kohë në të.

Shtëpia e Mallërave:



Fig. 31. Gjendja ekzistuese e hapësirës publike të Shtëpisë së Mallërave (nga autorët)

Nga shpërfytyrimi që i'u bë viteve të fundit, në vazhden e të ashtuquajturave "renovime", e gjysmuar mbeti edhe hapësira publike e Shtëpisë së Mallërave në Pejë (Fig.31). Si nga aspekti përmbajtësor e funksional, e edhe në atë të mirëmbajtjes, lë shumë për të dëshiruar. Në vitin 2021 është propozuar rregullimi i një zone në përdheshën e ndërtesës, e cila është në kontrast total me rrethinën, mveshjen e pjesërishme të objektit dhe fasadën origjinale të tij. Një "aleancë" trepalëshe e cila krijon konflikt vizuel dhe dëshmon edhe njëherë mosaftësinë tonë kolektive për ruajtjen dhe mbrojtjen e këtyre hapësirave.

Në gjendjen në të cilën ndodhet sot, njëra pjesë është kantinë pune që tenton të realizojë projektin e para-

parë, ndërsa pjesa tjetër është e mbushur me vende për parking dhe dallohet një mungesë e gjelbërimit përreth zonës. Si një qendër e mirëfunksionalizuar nga brenda, ka një apetit të pranojë një fluks të konsiderueshëm të qytetarëve në baza ditore, shto këtu faktin që gjendet në një nga udhëkryqet me rrugët më të frekuentuara të qytetit të Pejës.

Me pak intervenime të mundshme, kjo hapësirë mund të jetë lehtë e qasshme për komunitetin në të ardhmen. Andaj, vizionimi i Shtëpisë së Mallrave në Pejë mund të përfshijë shtimin e gjelbërimit i cili me vete mund të përcillet me një mobiliar urban adekuat dhe intervenim në dysheme për orientim në hapësirë e cila padyshim do të mund të zbushte kaosin e lëvizjes në lokacion.



Fig. 32. Hapësira publike në përdheshën e Shtëpisë së Mallrave (nga autorët)

Pallati i Sporteve "Bill Clinton":

Shtëpia e shumë klubeve sportive dhe sportistëve, ka mirëpritur një numër të madh ndeshjesh të rëndësishme ndër vite. E vendosur në periferi të qytetit, hapësira publike përreth Pallatit të Sporteve "Bill Clinton" paraqet një nga zonat më atraktive të qytetit të Ferizajt. Në vitin 2020 është pajisur edhe me disa fusha sportive bashkëkohore të jashtme, përveç atyre ekzistuese, të cilat e kanë begatuar akoma më shumë peisazhin. Hapësira ka gjelbërim të mjaftueshëm, është e mirëmbajtur mirë, plotëson kriteret teknike dhe ofron qasje për të gjithë. Problem i vetëm mund të konsiderohet vetëm mungesa e mobiluarit urban e cila mund të konsiderohet e nevojshme si për pushim nga vizitorët, sportistët apo kalimtarët e rastit (Fig.33).

Vizionimi i kësaj hapësire qëndron në adresimin e problemit të vetëm të cilin e kemi konsideruar në hapësirën publike të Pallatit të Sporteve "Bill Clinton", e që është shtimi i inventarit urban. Ai mund të konceptohet në atë formë për të plotësuar nevojën fillestare të akterëve që marrim pjesë në hapësirë dhe në të njëjtën kohë të jetë intervenim artistik i cili do të krijonte ndjenjën e spontanitetit dhe befasisë.



Fig. 33. Gjendja ekzistuese e hapësirës publike në hyrje të Pallatit të Sporteve "Bill Clinton" (nga autorët)

**Bankkos -
pjesa administrative:**



**Fig. 34. Gjendja ekzistuese e hapësirës
publike pranë Bankkos-it në Ferizaj
(nga autorët)**

Bankkosi në qytetin e Ferizajt është gjithashtu një nga objektet e pakta të cilat kanë shpëtuar dhe arritur të ruajnë gjendjen e tyre burimore dhe origjinale. Pjesa verilindore e tij i takon bulevardit Adem Jashari, njëherit zona që ka më së shumti lëvizje në qytet. Ndërsa ana jugperëndimore e tij krijon një oazë të vogël në qytet e cila rrethohet me disa kafeteri të ndryshme. Meqenëse fasada ballore nga ana e sheshit nuk ka ndonjë problem të dallueshëm, zona prapa konsiderohet e zënë nga shërbimet e kafeneve dhe disa vendparkingje për banorët. Ka një mundësi të trupave ndriçues, mirëpo, hapësira është e mirëmbajtur dhe ofron qasje për të gjithë komunitetin (Fig.34).

Vizioni urban për një zgjidhje të shfrytëzimit të kënaqshëm të hapësirës mund të përmbajë rregullimin e disa problemeve teknike, sanimi i të cilave mundëson shfrytëzimin e hapësirës në çdo kohë të ditës dhe do të rriste ndjenjën e sigurisë. Shtimi i aktiviteteve të mundshme do të grumbullonte komunitetin dhe në të njëjtën kohë do të ngjallte ndjenjën e përkatësisë.




Fig. 35,36&37. Fotografi nga punëtoria vizionuese njëditore me studentë, e organizuar nga EC Ma Ndryshe dhe Iniciativa MODERNe (EC Ma Ndryshe)

VIZIONIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE MODERNE

Hulumtimi mbi hapësirat publike moderne në Kosovë përfundon duke shpalosur intervenime të detajuara, direkte, në hapësirën publike të Hotel "Grand" në Prishtinë, Teatrit profesionist të qytetit "Istref Begolli" në Pejë, Ndërtesës së Postës në Ferizaj dhe hapësirës publike pranë Ndërtesës së Radio "Prishtina" në Prishtinë.

Ky vizionim i këtyre katër hapësirave publike është paraprirë nga një punëtori vizionuese njëditore të organizuar nga EC Ma Ndryshe dhe Iniciativa MODERNe, me pjesëmarrjen e përzgjedhur të studentëve të arkitekturës, historisë dhe sociologjisë, me qëllim të përfshirjes së disiplinave dhe këndvështrimeve të ndryshme gjatë

diskutimit dhe vizionimit (Fig.35,36 &37). Pas analizës së gjendjes ekzistuese të secilit rast, janë shpalosur ide dhe koncepte për ndërhyrje në hapësira publike, duke u bazuar në përparësitë dhe potencialet që gëzon secila nga hapësirat dhe duke trajtuar mangësitë dhe problemet e identifikuar në secilin lokacion. Ky kapitull, rrjedhimisht, përshkruan gjetjet nga punëtorja vizionuese, së bashku me idetë e autorëve të këtij hulumtimi, ku tekstualisht dhe grafikisht janë vizionuar të katër hapësirat publike të pëzgjedhura, përmes ndërhyrjeve urbane lehtë të arritshme në realitet, me shpresë për të shtuar vëmendjen dhe për të intervenuar në hapësirat publike në të ardhmen e afërt.

HOTEL "GRAND", PRISHTINË

Hoteli me emrin "Grand", kurorë e cila kompletton ansamblin urbanistik të bulevardit "Nënë Tereza", shënon hyrjen e bulevardit nga jugu dhe fundin e tij nga veriu. Një pozitë e tillë vizionare e ndërtesës në kontekst urban, në afërsi me sheshin "Zahir Pajaziti", rrugën "Luan Haradinaj" dhe me ndërtesa të rëndësishme të qytetit, ka mundësuar që hapësirat rreth "Grand Hotel" të shndërrohen në hapësira publike vibrante, me një qarullim të madh të njerëzve. Hapësira publike e ndërtesës, gjegjësisht platoja e hotelit, është një hapësirë e madhe me mundësi të ndryshme për intervenim publik, është e qasur nga tre anë dhe është një hapësirë e qetë. Lidhet këndshëm me parkun "Heroinat", i cili shërben si një tampon zonë dhe zbut zhurmat e fluksit të levizjes, duke i ofruar platosë një efekt eskapizmi nga jeta dinamike e qytetit (Fig.38).

Megjithatë, pjesa e hyrjes kryesore e cila paraqet fytyrën e Grandit tashmë të transformuar, është shndërruar në një parking privat i cili shëmtton elegancën e Sallës së Konferencave që del si strehë nga kati i parë. Në anën tjetër, pavarësisht gjallërisë që e ka karakterizuar platonë në të kaluarën, sot ajo është shndërruar në një hapë-

sirë tërësisht të neglizhuar, me mirëmbajtje dhe monitorim të pamjaftueshëm, me dysheme dhe mobiliar urban të dëmtuar dhe mungesë të ndriçimit, duke shtuar akoma më shumë pasigurinë në lëvizje dhe keqtrajtimin e hapësirës në çdo kënd të saj (Fig.40). Hapësira publike nuk është e qasshme nga qytetarët me mundësi të kufizuara, përderisa shkallët të cilat të shpiejnë në plato nga oborri prapa hotelit janë tërësisht të dëmtuara, duke krijuar kështu një emocion "Kafkian" dhe aspakt ftues (Fig.42). Qasje më e lehtë, ndonëse aspak e arsyeshme, mund të konsiderohet nga ana jug-perëndimore e ndërtesës, përgjatë kafeterisë "Ma Belle".

Bazuar në gjetjet nga vizitat në terren dhe diskutimet gjatë punëtorisë njëditore me qëllim vizionimin e disa hapësirave publike moderne të përzgjedhura nga qytete të ndryshme të Kosovës, vizionimi i hapësirës publike të Hotel "Grand" bazohet në idenë e rigjenerimit të hapësirës dhe shndërrimin e saj në "landmark" të qytetit. Duke shfrytëzuar përparësitë e vetë lokacionit dhe potencialin që ka hapësira për t'u shfrytëzuar nga të gjitha grupmoshat e shoqërisë, koncepti synon evitimin e rrezikut të humbjes së identitetit modern që e përfaqëson

hapësirën dhe ngritjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike të objektit të Grand-it dhe hapësirave publike përreth tij.

Vizionimi parasheh rregullimin dhe theksimin e shkallëve, që paraqet hyrjen kryesore për në plato, përmes ndyrhyrjeve në dysheme dhe ndriçim të hapësirës (Fig.43); për të vazhduar më pas me integrimin e mobiliarit adekuat urban, ulëseve, shportave të mbeturinave, trupave ndriçues dhe rregullimin e dyshemesë urbane (Fig.39). Me qëllim për të ofruar sigurinë fizike e cila mungon në hapësirë, koncepti parasheh edhe shtimin dhe rregullimin e gardeheve afër shkallëve dhe përgjatë skajeve të platosë. Nisur nga mungesa e gjelbërimit në lokacion, vizionimi parasheh shtimin e gjelbërimit në hapësirat ekzistuese dhe të reja në plato, për të forcuar kështu akoma më

shumë lidhjen vizuale me parkun "Heroinat", ndërkohë që parasheh edhe vendosjen e disa tabelave informuese mbi ndërtesën e hotelit "Grand" dhe hapësirën publike përreth tij, me qëllim zhvillimin e identitetit dhe markës së hapësirave publike moderne në qytet. Përveç ndërhyrjeve që plotësojnë nevojat bazike të qytetarëve për të shfrytëzuar platonë, vizionimi ndjek idenë e krijimit të një hapësire fleksibile dhe multifunkionale, përmes vendosjes së pavilioneve, të cilët përmes tematikave të përkohshme dhe të ndryshueshme, do të mundësonin që hapësira e madhe e platosë të shfrytëzohej edhe për qëllime edukative e kulturore, për shfaqjen e filmave, mbajtjen e mësimit në hapësirë të hapur, organizimin e ekspozitave e diskutimeve publike, duke e rikthyer kështu ndjenjën e përkatësisë dhe lidhjen e qytetarëve me hapësirën publike të hotelit (Fig.41).

përparësitë

- » Pozita e ndërtesës në kontekst urban
- » Vlera historike, kulturore e arkitektonike e objektit të Grand Hotel
- » Afërsia e lokacionit me sheshin "Zahir Pajaziti" dhe rrugën "Luan Haradinaj"
- » Qasja në transportin publik në rrugët "Garibaldi" dhe "Luan Haradinaj"
- » Afërsia me ndërtesa të rëndësishme të qytetit
- » Afërsia me parkun "Heroinat"
- » Lokacion i identifikueshëm
- » Hapësirë e madhe me mundësi të ndryshme për intervenim publik
- » Qarkullimi i madh i njerëzve përreth Grand Hotel
- » Vizura të këndshme
- » Qasje në lokacion nga tre anë
- » Hapësirë publike e qetë

mangësitë

- » Hapësira jo e qasshme nga qytetarët me mundësi të kufizuara
- » Mungesë e mobiliarit adekuat urban
- » Dëmtim i mobiliarit urban ekzistues
- » Mungesa e mirëmbajtjes së rregullt
- » Dëmtim i dyshemesë
- » Shkallët joadekuate, pamundësojnë lëvizjen e lirë
- » Hapësirë e neglizhuar
- » Monitorim i pamjaftueshëm i lokacionit
- » Mungesa totale e ndriçimit
- » Mungesë e sigurisë fizike
- » Menaxhim joefikas i hapësirës nga autoritetet komunale
- » Mungesa e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike të zonës

mundësitë

- » Shfrytëzimi i pozitës së ndërtesës në kontekstin urban si gjenerator për zhvillim
- » Zhvillimi i identitetit dhe markës së hapësirave publike moderne në qytet
- » Përdorimi i fondeve nga burime tjera financiare përveç atyre nga institucionet komunale
- » Shfrytëzimi i përvojave dhe shembujve nga raste studimore
- » Shndërrimi i hapësirës në "landmark"
- » Hapësirë me potencial për shfrytëzim nga të gjitha grupmoshat
- » Lidhja e platosë me parkun "Heroinat"

kanosjet


- » Pengesat administrative në investimet dhe zhvillimet e kësaj hapësire
- » Mungesa e sigurisë për grupe të caktuara të shoqërisë
- » Vandalizmat në sipërfaqet përfaqëse
- » Perceptim i dobët i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike të objektit të Grand Hotel dhe hapësirës publike përreth tij
- » Humbja e identitetit modern që e përfaqëson hapësirën

**SITUACIONI I HAPËSIRËS
PUBLIKE TË HOTEL "GRAND"
NË PRISHTINË**
P. 1:500



**VIZIONIMI I HAPËSIRËS
PUBLIKE TË HOTEL "GRAND"
NË PRISHTINË**

- VENTOSJA E TRUPAVE NDRIQUES
- VENTOSJA E MOBILIARIT URBAN FLEKSIBIL
- RREGULLIMI DHE THEKSIMI I SHKALLËVE
- RREGULLIMI I GARDHEVE
- TABELA INFORMUESE



- RREGULLIMI I DYSHEMESË
- VENTOSJA E PAVILIONEVE
- PLOTËSIMI DHE RREGULLIMI I GJELBËRIMIT



Fig. 38. Para: Hapësira publike e platosë së Hotel "Grand" (nga autorët)



Fig. 39. Pas: Vizionimi i hapësirës publike të
platosë së Hotel "Grand" (nga autorët)



Fig. 40. Para: Hapësira publike e platosë së Hotel "Grand" (nga autorët)





Fig. 42. Para: Gjendja ekzistuese e shkallëve të Hotel "Grand" (nga autorët).



Fig. 43. Pas: Vizionimi i shkallëve të Hotel "Grand" (nga autorët)

TEATRI PROFESIONIST I QYTETIT "ISTREF BEGOLLI", PEJË

Teatri Profesional "Istref Begolli" është një prej ndërtesave moderne më të rëndësishme të qytetit të Pejës, simbol i vlerave shpirtërore dhe kulturore, që na rikujton traditën dhe historikun e ndritshëm të kulturës jo vetëm të Pejës, por të gjithë Kosovës. Pozita gjeo-trafike e favorshme në kontekst urban, afërsia me Lumbardhin e Pejës, afërsia me objektet tjera të rëndësishme të qytetit dhe hapësira e madhe publike përreth teatrit, gjegjësisht "Parku i Paqes", janë vetëm disa nga përparësitë e këtij lokacioni. Gjatë vizitës në terren kemi gjetur një hapësirë të qetë, me shumë gjelbërim, mobiluar urban adekuat, të ndriçuar mirë dhe me vizura të këndshme nga lumi, që të ofrojnë ndjenjën e qetësisë dhe paqes në hapësirë (Fig.44).

Megjithatë, është vënë re që hapësira anash teatrit nuk është e mirëmbajtur, shkallët kryesore të teatrit janë të dëmtuara dhe qasja për personat me mundësi të kufizuara nuk është e mundur (Fig.46). Për më tepër, hapësira publike kryesisht vizitohet nga e njëjta grupmoshë, përgjithësisht qyte-

tarë më të moshuar. Nisur nga mungesa e përmbajtjeve të tjera në park, rrjedhimisht pamundësia e shfrytëzimit të hapësirës në mënyra tjera, parku në përgjithësi shfrytëzohet për të kaluar nga njëra anë e qytetit në tjetrën, dhe pak nga kalimtarët ndalojnë për të kaluar kohë në të. Pavarësisht potencialit që ka, dallohet mungesa e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike të zonës.

Nisur nga kjo e fundit, vizioni për hapësirën publike përreth Teatrit Profesional "Istref Begolli" mbështetet në shfrytëzimin e lokacionit të teatrit si burim për zhvillimin e identitetit dhe markës së hapësirave publike moderne në Pejë. Koncepti bazohet në idenë e krijimit të mundësive për të shfrytëzuar hapësirën publike afër teatrit, përmes parimeve të fleksibilitetit dhe përshtatshmërisë së hapësirës për të gjitha grupmoshat e shoqërisë (Fig.45), si dhe ndërlihdjen e parkut me pjesën përtej lumit, përkatësisht me sheshin "Mbretëresha Teutë" në veri dhe me kinemanë "Jusuf Gërvalla" në jug.

Bazuar në faktin se shumë ndërtesa moderne në Pejë janë shpërftyruar apo janë të neglizhuara, një nga idetë kryesore të këtij vizionimi është ruajtja e identitetit të ndërtesës së teatrit dhe lidhja më e mirë e ndërtesës me hapësirën përreth tij. Së pari, kjo mund të arrihet me rregullimin e shkallëve dhe vendosjen e rampës në hyrje të teatrit, në mënyrë që ndërtesa të jetë e qasshme nga të gjitha grupet e shoqërisë. Së dyti, ideja e lidhjes së teatrit me parkun mund të arrihet duke "nxjerrë teatrin jashtë", ku përmes pavilioneve apo strukturave të ndryshme të përkohshme, pjesa e parkut pranë ndërtesës mund të shfrytëzohet për organizimin e shfaqjeve të ndryshme teatrale në natyrë, apo për krijimin e kinemave të hapura, duke forcuar kështu lidhjen e teatrit me

kinemanë "Jusuf Gërvalla" (Fig.47). Përmes mobiliarit urban fleksibil, hapësira mund të shfrytëzohet edhe për qëllime tjera, për të ofruar kështu mundësinë që të gjitha grupmoshat e shoqërisë të shfrytëzojnë hapësirën për nevojat e tyre, si dhe për të evituar rikthimin e nofkës "Plaku i Pleqve". Një nga pjesët e parkut është menduar të pajiset me pajisje të palestrës së hapur dhe jogës, me qëllim që afërsia e lumit dhe gjelbërimi ekzistues të shfrytëzohen për aktivitet fizik dhe jetë të shëndetshme, nevojë kjo shumë e shprehur gjatë aktualitetit të pandemisë. Vendosja e tabelave informuese nëpër park e përtej mendojmë se është e domosdoshme për të ngritur vetëdijen mbi vlerat dhe rëndësinë e ndërtesës së teatrit dhe hapësirës publike moderne pranë tij.

përparësitë

- » Pozita gjeo-trafike e favorshme në kontekst urban
- » Hapësirë e madhe për intervenim
- » Hapësirë e pasur me gjelbërim
- » Hapësirë e ndriçuar mirë
- » Prania e mobiliarit urban
- » Zonë e qetë për pushim
- » Vizura të këndshme
- » Afërsia me objekte të rëndësishme të qytetit
- » Afërsia me lumin

mangësitë

- » Mungesa e mirëmbajtjes anash teatrit
- » Shkallët e teatrit të dëmtuara
- » Hapësira kryesisht shfrytëzohet nga e njëjta grupmoshë
- » Qasja për persona me mundësi të kufizuara në teatër nuk është e mundur
- » Mungesa e aktiviteteve të lira
- » Monitorim i pamjaftueshëm i hapësirës
- » Menaxhim joefikas i hapësirës
- » Mungesa e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike të zonës

mundësitë

- » Shfrytëzimi i pozitës gjeo-trafike si burim për zhvillim
- » Zhvillimi i identitetit dhe markës së hapësirave publike moderne në qytet
- » Përdorimi i fondeve nga burime tjera financiare, përpos atyre nga institucionet komunale
- » Shfrytëzimi i përvojave dhe shembujve nga raste studimore
- » Mundësi shfrytëzimi nga të gjitha grupmoshat
- » Ndërlidhja me pjesën përtej lumit, përkatësisht me sheshin "Mbretëresha Teutë"
- » Promovimi i Teatrit përmes hapësirës publike

kanosjet

- » Pengesat administrative në investimet dhe zhvillimet e kësaj hapësire
- » Vandalizmat në sipërfaqet përqark
- » Rikthimi i nofkës "Parku i Pleqve"
- » Humbja e identitetit të objektit

SITUACIONI I HAPËSIRËS PUBLIKE TË
NDËRTESES SË TEATRIT "ISTREF BEGOLLI"
NË PEJË
P. 1:300

BULEVARDI "MBRETËRESHA TEUTË"

LUMBARDHI I PEJËS

PARKU I PAQES

RRUGA "WILLIAM WALKER"



PALESTËR E HAPUR

HAPËSIRË FLEKSIBILE

DIZAJNIMI I RAMPËS DHE RREGULLIMI I SHKALLËVE

VIZIONIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE TË NDËRTESES SË TEATRIT "ISTREF BEGOLLI" NË PEJË

BULEVARDI "MBRETËRESHA TEUTË"

LUMBARDHI I PEJËS

PARKU I PAQES

PLOTËSIMI DHE RREGULLIMI I GJELBËRIMIT

TABELA INFORMUESE

HAPËSIRË REKREATIVE

EKSPOZITA DHE SHFAQJE TË HAPURA

KINEMAJA "JUSUF GËRVALLA"






Fig. 44. Para: Gjendja ekzistuese e Parkut të Paqes në Pejë (nga autorët)





Fig. 46. Para: Hapësira publike pranë Teatrit Profesional të Pejës (nga autorët)




Fig. 47. Pas: Shfrytëzimi i hapësirës publike pranë Teatrit si kinema e hapur
(nga autorët)

NDËRTESA E POSTËS, FERIZAJ

E vendosur në bulevardin kryesor të qytetit të Ferizajt, me rëndësinë e saj historike, kulturore dhe arkitektonike, Ndërtesa e Postës i jep akoma më shumë vlera hapësirës me identitet modern që e rrethon. Nga përparësitë e shumta që e karakterizojnë këtë ndërtesë, do të përmendim lokacionin e dallueshëm, lokalet e shumta që e rrethojnë, rrjedhimisht fluksi i madh i madh i njerëzve që qarkullojnë rreth saj dhe afërsinë me Bibliotekën e qytetit "Sadik Tafarshiku". Si pasojë e funksionit të ndërtesës, hapësira publike pranë saj është e ndriçuar mirë, është e qasshme nga çdo grup shoqëror dhe është vazhdimisht e monitoruar, përparësi këto që i shtojnë akoma më shumë kualitet hapësirës.

Megjithatë, Ndërtesa e Postës duket e ngulfatur nga ndërtesat të cilat i

janë ngjitur pranë në anën lindore të saj, të cilat cenojnë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike të zonës. Për më tepër, fluksi i lëvizjes shkakton zhurmë dhe ndotje, në veçanti në xhepin e vogël të gjelbërimit përpara ndërtesës. Nga vizitat e lokacionit është dalluar një menaxhim joefikas i zonës në përgjithësi, mirëmbajtje jo e kënaqshme dhe mungesë e mobiliarit urban adekuat. Për dallim nga parku i Bibliotekës i cili shfrytëzohet nga vizitorët e saj, vlen të theksohet se ndonëse Ndërtesa e Postës është e frekuentuar për shkak të nevojës për të kryer shërbimet postare, hapësira e vogël e gjelbërimit pranë saj është e neglizhuar, ndërsa hapësira publike e përdhësës së lirë përdoret vetëm si pikëtakim apo hapësirë për pritje (Fig.48).

Duke u bazuar në gjetjet nga hulumtimi, vizitat në terren dhe nga punëtorja njëditore për vizionimin e hapësirave publike moderne të Kosovës, vizioni për hapësirën publike të Ndërtesës së Postës në Ferizaj mbështetet në idenë e shfrytëzimit të përdhësës së lirë të ndërtesës dhe krijimin e lidhjes mes sheshit "Hyre Emini" dhe parkut të ri që po ndërtohet përgjatë hekurudhës. Një nga ndërhyrjet e domosdoshme në lokacion është theksimi i ndërtesës, dukshmëria e së cilës cenohet jo vetëm nga ndërtesat anash saj por edhe nga bankomatët e vendosur në hapësirën e gjelbërimit përpara ndërtesës. Prandaj, propozimi parasheh zhvendosjen e bankomatëve në anën e prapme të ndërtesës, për të zbuluar kështu fasadën ballore të saj nga ana e bulevardit.

Ndërlidhja mes dy bulevardeve është ideuar të arrihet përmes definimit të dyshemesë urbane, duke theksuar kështu hapësirën mes Ndërtesës së Postës dhe Bibliotekës (Fig.51). Për të sjellë atraktivitet dhe për t'a bërë më inte-

resante pritjen, hapësira e përdhësës së ndërtesës është vizionuar si një hapësirë e përshtatshme për instalacione të artit modern, përderisa hapësira e gjelbërt përpara ndërtesës mund të shfrytëzohet për ekspozita të ndryshme të përkohshme, të cilat do të tërhiqnin vëmendjen e kalimtarëve të bulevardit (Fig.49). Ndërlidhja me hapësirën e gjelbërt përballë Bibliotekës dhe parkun e ri pranë hekurudhës është një tjetër ide e këtij koncepti, e cila mund të arrihet përmes vendosjes së mobiliarit urban uniform dhe shtimit të gjelbërimit në të gjithë hapësirën përreth ndërtesës. Me qëllim për të evituar okupimin e hapësirës dhe vandalizmat në sipërfaqet e ndërtesës, fasada veri-lindore e Postës është paraparë për një eksperiment bashkëpunues që synon të lidh njerëzit me njëri-tjetrin dhe me qytetin, "Projection Bombing" (Fig.50), ku përmes projektimit të imazheve, mjedis i përditshëm transformohet në një skenë e cila në mënyrë retorike ekspozon potenciale të reja për përvojën urbane dhe trajton në mënyrë kritike mangësitë e perceptuara në qytet .

përparësitë

- » Vendodhja në bulevardin kryesor të qytetit
- » Hapësirë me identitet modern
- » Vlera historike, kulturore e arkitektonike e objektit të Postës
- » Lokacion i dallueshëm
- » Qarkullimi i madh i njerëzve
- » Lokalet e përhapura në perimetrin e jashtëm të lokacionit
- » Hapësira ofron qasje për personat me mundësi të kufizuara
- » Prania e gjelbërimit të ulët, të mesëm dhe të lartë
- » Afërsia me bibliotekën e qytetit "Sadik Tafarshiku"
- » Hapësirë e ndriçuar mirë
- » Hapësirë vazhdimisht e monitoruar

mangësitë

- » Afërsia me objektet tjera përreth
- » Fluksi i lëvizjes shkakton zhurmë dhe ndotje
- » Mirëmbajtje jo e kënaqshme e gjelbërimit
- » Mungesa e mobiliarit adekuat urban
- » Menaxhim joefikas i hapësirës
- » Mungesa e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike të zonës

mundësitë

- » Shfrytëzimi i pozitës gjeo-trafike si burim për zhvillim
- » Zhvillimi i identitetit dhe markës së hapësirave publike moderne në qytet
- » Përdorimi i donacioneve nga burime tjera financiare përveç atyre nga institucionet komunale
- » Shfrytëzimi i përvojave dhe shembujve nga raste studimore
- » Mundësia e lidhjes me dy bulevardet
- » Shfrytëzimi i përdhësës së lirë
- » Shfrytëzimi i hapësirës së gjelbërt në hyrjen kryesore

kanosjet

- » Pengesat administrative në investimet dhe zhvillimet e kësaj hapësire
- » Okupimi i hapësirës nga bankomatet
- » Vandalizmat në sipërfaqet përqark
- » Perceptim i dobët i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike të objektit të Postës dhe hapësirës publike përreth tij

SITUACIONI I HAPËSIRËS PUBLIKE
TË NDËRTESESË SË POSTËS
NË FERIZAJ
P. 1:300






Fig. 48. Para: Hapësira publike në përdheshën e Ndërtesës së Postës në Ferizaj (nga autorët)






Fig. 50. Shfrytëzimi i fasadës veri-lindore të Postës për "Projection Bombing"
(nga autorët)



Fig. 51. Intervenimet në hapësirën publike pranë Ndërtësës së Postës në Ferizaj (nga autorët)

RADIO "PRISHTINA", PRISHTINË

Radio "Prishtina" është një nga pak objektet në Prishtinë që i ka shpëtuar një shpërftyrimi të mundshëm dhe ka qëndruar i njëjtë për nga forma apo funksioni. Ndryshime nga viti në vit janë realizuar në hapësirën publike rreth tij, megjithatë, Radio "Prishtina" është një ndërtesë me vlera historike, kulturore e arkitektonike, e vendosur në një hapësirë me identitet modern, me një pozitë shumë të favorshme në qytet. Duke qenë mes sheshit "Zahir Pajaziti" në veri, parkut të ri të qytetit në jug, përkaj rrugës "Xhorxh Bush" dhe pranë Kampusit Universitar në lindje, ndërtesa është e qasshme nga të gjitha llojet e transportit, mes fluksit më të madh të njerëzve që qarkullojnë nëpër qendrën e qytetit.

Megjithatë, e rrethuar jo vetëm nga gjelbërimi i shumëllojshëm por edhe nga gardhi përreth, brenda perimetrit të gardhit kjo ndërtesë dhe hapësira e saj publike duket si një fluskë e veçuar dhe në dispozicion vetëm të nëpunësve dhe personave mediatik të Radio Televizionit të Kosovës dhe mediae të tjera. Pjesa më e madhe e hapësirës është e zënë nga parkingjet e nëpunësve të ndërtesës (Fig.55),

dallohet mungesa e mobiliarit urban, ndriçimit, shtigjeve për këmbësorë, mirëmbajtje jo e kënaqshme, vështirësi në qasje për personat me mundësi të kufizuara, kualitet jo i mirë i dyshemesë urbane, menaxhim joefikas i hapësirës, e rrjedhimisht, mungesë e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike të zonës (Fig.53).

Një hapësirë publike moderne e tillë, me kaq shumë probleme, është njëkohësisht një hapësirë me shumë potencial për të ndryshuar në favor të qytetarëve. Ky ndryshim duhet të fillojë që nga deterritorializimi i hapësirës, largimi i tabelave që mbulojnë fasadat e ndërtesës dhe largimi i gardhit që rrethon hapësirën publike, për t'a hapur atë për qytetarët e saj dhe për të krijuar një lidhje më të mirë të hapësirës publike të ndërtesës me të gjithë hapësirën e pasur publike rreth saj. Hapi tjetër i vizionimit është zhvendosja e parkingjeve në parkingun nëntokësor në jug të ndërtesës së Radio Prishtinës, duke lënë hapësirë vetëm për parkingje të shpejta në skajin verior të lokacionit, pranë rrugës, ashtu që e tërë hapësira të shfrytëzohet vetëm nga këmbësorët. Për të arritur këtë është e nevojshme

rregullimi i shkallëve dhe rampave në dy skajet perëndimore të lokacionit, për të ofruar një qasje më të mirë për të gjitha grupet e shoqërisë.

Duke qenë se fluksi i makinave shkakton zhurmë dhe ndotje, dhe koncepti mbështetet në idenë e krijimit të një hapësirë të këndshme dhe të qetë në pjesën e përparme të ndërtesës, vizionimi parasheh zhvendosjen e gjelbërimit që kamuflon faqen ballore të objektit në pjesën e gjelbërimit pranë rrugës, me qëllim që të krijohet një tampon zonë e cila ofron qetësi në hapësirën publike pranë ndërtesës, dhe njëkohësisht mundësohet një dukshmëri më e mirë e ndërtesës së Radio Prishtinës. Përmes mobiliarit urban adekuat dhe fleksibil, kjo hapësirë mund të përqafojë dhe promovojë integrimin dhe solidaritetin social gjithëpërfshirës në hapësirat publike moderne në qytet (Fig.54).

Meqenëse rruga mes Rektoratit të Universitetit të Prishtinës dhe objektit të Radios është shumë e frekuentuar, koncepti parasheh që përmes ndërhyrjeve në dyshtemenë urbane, të kirijohet një lidhje me hapësirën publike të Kampusit Universitar, ku përmes rifunksionalizimit të "Kiosk K67" (Fig.57), e cila gjendet në mes të këtij trekëndëshi, të krijohet një tërësi e madhe, multifunksionale, e hapësirave publike të të gjithë zonës. Për sa i përket hapësirës totalisht të neglizhuar prapa ndërtesës, duke shfrytëzuar pjerrtësinë e terrenit, vizionimi parasheh krijimin e një amfiteatri shumë të nevojshëm në Kampusin Universitar. Në këtë rast, studentët dhe të gjithë përdoruesit tjerë të amfiteatrit, do ta gjenin veten të ulur në një hapësirë atraktive mes dy ndërtesave ikonike të kryeqytetit, Radio Prishtinës dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

përparësitë

- » Pozita gjeo-trafike e favorshme e lokacionit në qytet
- » Hapësirë me identitet modern
- » Vlera historike, kulturore e arkitektonike e objektit të Radio Prishtinës
- » Lokacioni i dallueshëm
- » Prania e institucionit të Radio Prishtinës dhe disa medieve të tjera kombëtare
- » Dy kafene brenda perimetrit të lokacionit
- » Lokalet e përhapura në perimetrin e jashtëm të lokacionit
- » Rruga "Xhorxh Bush" ofron qasje për të gjitha llojet e transportit lokal
- » Qarkullimi i madh i njerëzve
- » Prania e gjelbërimit të ulët, të mesëm dhe të lartë
- » Rrjeti ekzistues elektrik, rrugor dhe i kanalizimit në lokacion
- » Afërsia me sheshin "Zahir Pajaziti"
- » Afërsia me Parkingun Nëntokësor

mangësitë

- » Parkingjet zënë pjesën më të madhe të hapësirës
- » Mungesa e shtigjeve për këmbësorë brenda lokacionit
- » Mungesa e qasjes për personat me mundësi të kufizuara
- » Fluksi i lëvizjes shkakton zhurmë dhe ndotje
- » Mungesa e aktiviteteve të lira
- » Mungesa e trupave ndriçues
- » Monitorim i pamjaftueshëm i lokacionit
- » Mirëmbajtje jo e kënaqshme
- » Mungon pllakosja e disa shtigjeve
- » Mungesë e dallueshme e mobiliarit urban
- » Menaxhim joefikas i hapësirës
- » Mungesa e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike të zonës

mundësitë

- » Shfrytëzimi i pozitës gjeo-trafike si burim për zhvillim
- » Zhvillimi i identitetit dhe markës së hapësirave publike moderne në qytet
- » Zhvillimi dhe zbatimi i një planprogrami për integrimin dhe solidaritetin social e gjithëpërfshirës të hapësirave publike moderne në qytet
- » Përdorimi i fondeve nga burime tjera financiare, përpos atyre nga institucionet komunalet
- » Shfrytëzimi i përvojave dhe shembujve nga raste studimore
- » Prania e "Kiosk K67"
- » Shfrytëzimi i rrugës ndërmjet Rektoratit të Universitetit të Prishtinës dhe objektit të Radio Prishtinës si urë lidhëse me kampusin universitar
- » Shfrytëzimi i vendparkingjeve në Parkingun Nëntokësor

kanosjet

- » Pengesat administrative në investimet dhe zhvillimet e kësaj hapësire
- » Shfrytëzimi i objektit dhe hapësirës për mesazhe komerciale
- » Përceptim i dobët i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike të objektit të Radio Prishtinës dhe hapësirës publike përreth tij

SITUACIONI I HAPËSIRËS PUBLIKE TË
NDËRTESES SË RADIO "PRISHTINA"
NË PRISHTINË
P. 1:300



KAMPUSI UNIVERSITAR

VIZIONIMI 1 I HAPËSIRËS PUBLIKE
TË NDËRTESES SË RADIO "PRISHTINA"
NË PRISHTINË




Fig. 52. Transformimi artistik i kabinës së sigurimit
(nga autorët)



Duke marrë parasysh mundësitë e realizimit të ndërhyrjeve të propozuara më lartë dhe faktin se vizionimi i përshkruar është vështirë i arritshëm, humtimi rezulton edhe me një vizionim të dytë për hapësirën publike të Radio "Prishtina", i cili është më lehtë i realizueshëm. Duke u bazuar në nevojën për parkim të automjeteve nga punonjësit e ndërtesës, ky koncept parasheh largimin e automjeteve vetëm nga ana perëndimore e hapësirës publike dhe ruajtjen e vendparkingjeve në pjesën veriore të hapësirës. Në këtë mënyrë sërish mund të arrihet koncepti i ndarjes së këmbësorëve nga automjetet, ashtu që e tërë hapësira publike përpara ndërtesës së Radios të shndërrohet në një hapësirë publike dinamike, të plotësuar me ndërhyrje në formë të artit publik në dysHEME, mobiluar urban fleksibil dhe gjelbërim të ri (Fig.56).

Në pjesën veriore është propozuar ruajtja e kabinës së sigurimit, me një

transformim artistik të pamjes së saj të jashtme (Fig.52), përderisa gardhi ekzistues është ruajtur vetëm në pjesën e ndarjes së automjeteve nga hapësira publike në veri të saj. Rikufunksionalizimi i "Kiosk K67" është një nga idetë kryesore të këtij vizionimi, ku pas pastrimit dhe riorganizimit të hapësirës brenda dhe jashtë Kioskës (Fig.58), ajo mund të shndërrohet në një kafeteri të vogël e cila do t'u shërbente studentëve dhe kalimtarëve të kësaj pjese të qytetit, ndërsa përmes shpërndarjes së materialeve me informata për Iniciativën MODERNE, Kioska do të ndikonte në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë moderne në Kosovë (Fig.59). Pastrimi dhe rregullimi i hapësirës përreth Kioskës, së bashku me amfiteatrin e propozuar, do të krijonin një hapësirë fleksibile me mundësi të shumta shfrytëzimi dhe do t'i shtonin akoma më shumë jetë hapësirës publike të Kampusit Universitar të qytetit.

**VIZIONIMI 2 I HAPËSIRËS PUBLIKE
TË NDËRTESES SË RADIO "PRISHTINA"
NË PRISHTINË**






Fig. 53. Para: Hapësira publike përpara Ndërtesës së Radio "Prishtina" (nga autorët)





Fig. 55. Para: Shfrytëzimi i hapësirës publike të Radio "Prishtina" si parking
(nga autorët)



Fig. 56. Pas: Shndërrimi i parkingut në një hapësirë publike dinamike
(nga autorët)

KIOSKA K67 - një dizajn modern në zhdukje

Gjatë vizitës në terren është pikasur një nga gjetjet më të rëndësishme të këtij hulumtimi: Një dizajn klasik slloven i viteve të 60-ta, "Kiosk K67", e cila për vite me radhë qëndron e fshehur në skajin veri-lindor të hapësirës publike të Radio "Prishtina", gati e padukshme nga ana tjetër e gardhit, është shndërruar në depo dhe është e rrethuar me mbeturina.

Kioska K67 u prezentua në vitin 1966 nga arkitekti slloven Saša Janez Mächtig, i cili me dizajnin e tij përqafoi materiale të reja industriale, së bashku me logjikën e prodhimit masiv. Sistemi i tij bazohej në module të çelikut dhe qelqit, të përforcuara me polifibër, të cilat mund të përdoren si njësi të vetme ose të kombinuara në grumbullime më të mëdha. Dizajni i unifikuar funksional i njësive u mundëson atyre të përshtaten në pothuajse çdo vendndodhje dhe kontekst, me funksione nga më të ndryshmet. Këto kioska u shpërndanë përtej Jugosllavisë, në të gjithë botën, ku u përshtatën për përdorime të ndryshme si kioska gazetash, stenda të tregut, kafeteri studentësh, koshere bletësh, kabina biletash apo stenda për shitje me pakicë dhe ushqim të shpejtë (Architectuul, 2021).

Ajo që e dallon K67 është pozicioni i

saj midis arkitekturës dhe dizajnit industrial, përfshirja në kuadër të qytetit, shoqërisë moderne dhe ritualeve të jetës së përditshme, si dhe aftësia e saj e vazhdueshme për të rikrijuar veten. Sistemi i Kioskës lejon konfigurime dhe variacione të pakufizuara dhe ka aftësinë e pafund që nuk rresht kurrë së befasuari (ArchDaily, 2017). Megjithatë, të befasuar na gjeti fakti që një element kaq i rëndësishëm i trashëgimisë moderne, në Kosovë gjendet i braktisur në ndonjë cep të një parkingu, i përdorur për të shitur pije në ndonjë park apo i lënë tërësisht pas dore në ndonjë hapësirë publike të pashfrytëzuar.


Konsiderojmë që është koha për të kthyer në qendër të vëmendjes një artefakt, që ka në koleksionin e saj të dizajnit të shekullit XX edhe Muzeu i Artit Modern (MoMA) në Nju Jork, një dizajn klasik që mund ta gjejmë akoma në të gjithë rajonin, megjithëse shpesh në gjendje të neglizhuar. Shumë prej kioskave kanë mbetur akoma në përdorim, ca janë zhdukur, e të tjera qëndrojnë të braktisura, në pritje për t'u rizbuluar nga eksploruesit urban. Një të tillë gjetëm teksa po mbanim sytë hapur, vigjilent ndaj mjedisit urban, dhe po synojmë që të njëjtës t'i rivendosim shkëlqimin e saj origjinal.



Fig. 57. Para: Gjendja ekzistuese e Kiosk K67 (nga autorët)



Fig. 58. Pas: Vizionimi i Kiosk K67 (nga autorët)





PËRFUNDIM

Përmes vizionimit të disa prej hapësirave publike moderne me më shumë potencial për intervenim, ky hulumtim nxjerr në pah vlerat dhe rëndësinë e trashëgimisë moderne të shekullit XX në disa nga qendrat kryesore të Kosovës. Përmes hulumtimit dhe analizave të hapësirave të përzgjedhura, është kuptuar një mungesë e përkujdesjes institucionale dhe vetëdijes shoqërore mbi rëndësinë e periudhës dhe trashëgimisë së pasur moderne në vend, e rezultatet rekomandojnë nevojën urgjente për të vazhduar hulumtimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe promovimin e saj, duke mos pritur që një shpërfytyrim tjetër i këtyre ndërtesave dhe hapësirave të shërbejë si mësim apo kujtesë për ne.

Ndërtesat kryesore publike të kësaj periudhe, së bashku me hapësirat publike që i shoqërojnë, i kanë mbijetuar

rrjedhës së kohës, periudhave të mospërfilljes dhe shkatërrimit ndër vite. Megjithatë, ato janë gjithnjë të rrezikuara nga evoluimi i dukshëm i zonave urbane dhe tendencat e planifikimit urban bashkëkohor të cilat i shohin këto ndërtesa dhe hapësira si pengesa për zhvillimin e qyteteve, e jo si vlera unike të cilat i japin identitet vendit dhe reflektojnë historinë e tij.

E nga ne si profesionistë, institucionet përgjegjëse dhe komuniteti në përgjithësi, pritët që të trajtojmë hapësirat publike moderne bazuar në potencialin që ato bartin dhe gjendjen aktuale që i karakterizon, gjithmonë duke respektuar rëndësinë dhe vlerat e trashëgimisë, në funksion të mbrojtjes nga çfarëdo lloj dëmtimi, përdorimi i papërshtatshëm apo ndryshimi që cenon humbjen e vlerave historike, arkitektonike dhe kulturore të tyre.

REFERENCAT

1. ArchDaily. (2017). The Story of the 1960s Mass-Produced Modular Design That Actually Went into Production. Marrë nga <https://www.archdaily.com/806346/the-story-of-the-1960s-mass-produced-modular-design-that-actually-went-into-production>
2. Architectuul. (2021). Ljubljana, Slovenia by Saša Mächtig. Marrë nga <http://architectuul.com/architecture/k67>
3. Beqiri, F. X. (2018a). The undiscovered modern architecture of Kosovo. Architectural Icon / Piranesi, No. 40/Vol. 26.
4. Beqiri, F. X. (2018b). Andrija Mutnjaković: National Library of Kosovo, Prishtina, Kosovo, 1971-1984. Architectural Icon / Piranesi, No. 40/Vol. 26.
5. Beqiri, F. X., & Navakazi, V. (2018). The Life of Kosovo Modernism. In A. Tostões & N. Koselj (Eds.), *Metamorphosis. The Continuity of Change* (pp.102-108). Lubljanë, Slloveni: Docomomo Slovenia.
6. Beqiri, F. X. (2020). PUBLIKE DHE MODERNE - Kanosja e memories kolektive në relacion me objektet dhe hapësirat publike të periudhës moderniste. Prishtinë, Kosovë: EC Ma Ndryshe.
7. Beqiri, F. X. (2021). Modern Architecture of Kosovo, a regional based architectural epicenter. In 16th International DOCOMOMO Conference, *Inherited Resilience: Sharing Values of Global Modernities*. Tokio, Japoni.
8. Berisha, S. (2010). "Teatri i Pejës" - Monografi.
9. Davis, B. (2019). The Bauhaus in History. Artnet Magazine. Marrë nga https://static1.squarespace.com/static/529fc7ede4b0b1af9175c11e/t/52b310a9e4b067ba98943b55/1387466921358/The+Bauhaus+in+History++Artnet+2010-01-28.pdf?fbclid=IwAR1PU1ss_wTTQsUoT8P3JiMjQEYT-DODumnZs13ogzj9zA08c9FL-DXV7U
10. Drenogllava, E. (2021). Shkëlqimi dhe rënia e Prishtinës: fragmentimi i qytetit përmes skicimeve urbane - në kërkim të së bukurës utopike. Prishtinë, Kosovë: Punim i diplomës master jo i publikuar.
11. Elezi, K., & Sadiki, A. (2017). *Modernizmi në Ferizaj, 1960-1990*. Prishtinë, Kosovë: Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapsinor, UBT.
12. Galeria Kombëtare e Kosovës. (2020). Marrë nga https://sq.wikipedia.org/wiki/Galeria_Komb%C3%ABtare_e_Kosov%C3%ABs#cite_note-rks-gov-1
13. Gropius, W. (1965). *The New Architecture and the Bauhaus*. Massachusetts, SHBA: The MIT Press.

14. Gjinolli, I. (2015). Public Space in Kosovo - Transformation Through History. Graz, Austri: Dissertation, TU Graz.
15. Gjinolli, L., & Kabashi, L. (2015). Modernizmi Kosovar: një abetare e arkitekturës. Prishtinë, Kosovë: Galeria Kombëtare e Kosovës.
16. Hersher, A. (2010). Violence Taking Place. The Architecture of the Kosovo Conflict. Kalifornia, SHBA: Stanford University Press.
17. Hoxha, E. (2013). Qyteti dhe dashuria. Ditari urban. Prishtinë, Kosovë: Qendra për Hulumtime humanistike, 2013.
18. Jashari-Kajtazi, T. (2016). Behind the national identity. Political and Social Activity through Architecture - Liberal Socialism in Kosovo. Vienë, Austri: Dissertation, TU Wien.
19. Jerliu, F. (2014). Prishtina reinterpreted, interrogating heritage-memory-identity triad in the contemporary context. Sarajevë, Bosnja dhe Hercegovina: PhD Thesis, University of Sarajevo.
20. Jerliu, F., & Navakazi, V. (2019). Modernization tendencies in architecture and street infrastructure in Kosovo during the Tanzimat reforms. ResearchGate. doi: 10.1556/606.2019.14.2.7
21. Llonçari, Xh. (2004). Arkitektura dhe Urbanizmi Sinergjik. Prishtinë, Kosovë: Kashi.
22. NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. (2019). Marrë nga <https://www.sap-rks.com/sq/stacioni-i-autobuseve-prishtine/>
23. Prishtina Online. (2018). Nesër përurohet sheshi Adem Jashari. Marrë nga <https://prishtinaonline.com/kerkimi/1772/neser-perurohet-sheshi-adem-jashari>
24. Sadiki, A. (2020). Arkitektura e ndërtesave publike në Prishtinë: 1945-1990. Faktorët shoqëror dhe formësues. Prishtinë, Kosovë: NTG Blendi
25. Stierli, M., & Kulić, V. (2018). Toward a Concrete Utopia: Architecture in Yugoslavia 1948-1980. Nju Jork, SHBA: Museum of Modern Art.
26. Shani Nushi Sports Hall. (2020). Marrë nga https://en.wikipedia.org/wiki/Shani_Nushi_Sports_Hall
27. Zukin, Sh. (2010). The City That Lost Its Soul. In Naked City: The Death and Life of Authentic Urban Places. Nju Jork, SHBA: Oxford University Press.

Rreth EC Ma Ndyshe

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore. Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijës empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjate duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët etreta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020-2024) ka këto elemente:

1. Gjithëpërfshirjen,
2. Qëndrueshmërinë, dhe
3. Dijen.

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë-lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijës së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. **Paanshmëri** - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe menjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyj përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahë këtë opsion.
2. **Aktivizmi** - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës.
3. **Orientimi drejt rezultateve** - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftëse nuk përfundon me rezultatet e pritura.
4. **Komuniteti, bazë e veprimit** - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.

Rreth MODERNe

MODERNe - Iniciativa për Vlerësimin, Mbrojtjen dhe Promovimin e Trashëgimisë Moderne në Kosovë, është nismë me bazë në grup profesionistësh dhe përfaqësues të komunitetit me qëllim të vlerësimit, mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë moderne në qendrat kryesore të Kosovës. Qëllimi i iniciativës është nxitja e debatit publik mbi vlerat e trashëgimisë së shekullit XX dhe zhvillimeve sociale, kulturore e ekonomike që përcollën fillet dhe zhvillimin e arkitekturës dhe artit modern në Kosovë. MODERe synon që përmes hulumtimit, dokumentimit dhe kultivimit të diskutimit publik mbi vlerat e trashëgimisë moderne të arrijë të kontribuojë në mbrojtjen dhe promovimin kësaj pjese të rëndësishme të trashëgimisë tonë. Iniciativa MODERNe vepron në cilësi të programit të veçantë në kuadër të EC.

EC
MA NDARYSHE

M
MODERNITY
... HIGHLY PROFESSIONAL AND QUALITY
TECHNOLOGY TO SUPPORT BUSINESS OF CLIENTS